

VALTER MEMISHA

**RRETH VLERAVE GJUHËSORE TË VEPRËS
FJALORI LEKSIKO - FRAZELOGJIK I DEVOLLIT,
HARTUAR NGA ALI JASHARI**

Para pak kohësh (më 2016) doli në qarkullim vepra *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit*, i hartuar nga prof. Ali Jashari¹. Ajo është një arritje e re me peshë në punën e këtij autori që njihet, ndër të tjera, si leksikolog e leksikograf i formuar, i identifikuar përmes punimeve monografike, botimeve leksikografike, përmbledhjeve studimore, si dhe artikujve të shumtë e kumtimeve shkencore. Vepra është prurje dhe për vetë leksikografinë e gjuhës shqipe, duke zënë vend të veçantë në botimet për leksikografinë dialektore. Akademiku Gj. Shkurtaj, që e shoqëron botimin me një fjalë përcjellëse, shkruan se “Pasi e kam lexuar dhe rilexuar këtë vepër, arrij në përfundimin se ky fjalor është një enciklopedi e plotë e shpirtit të popullit të Devollit, e kulturës dhe e gjuhës së tij, e traditave dhe zakoneve, duke pasqyruar shtresa të tëra fjalësh që lidhen me jetën materiale dhe shpirtërore, madje edhe shumë fjalë që sot janë bjerrur nga përdorimi për shkak të ndryshimeve të kushteve ekonomike e shoqërore.”²

Ku dhe si duhen kërkuar vlerat e kësaj vepre:

1. *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit* mishëron një punë dhjetërvjeçare të autorit, që nis me mbledhjen e pasurisë leksikore e frazeologjike të të folmes së Devollit, vendlindjes së tij, që kur mbaroi studimet e larta në Universitetin e Tiranës për gjuhë shqipe e letërsi e deri më sot. Ai është kurorëzim i punës vjelëse e grumbulluese në terren, në ekspedita të institucionalizuara e së shumti në ato vetjake, në vjelje leksikore (e më gjerë) nëpër fshatra e në qytete, në biseda me të moshuar, por edhe me të moshës së mesme, të cilët kanë qenë si burim i pasurisë së

¹ Ali Jashari, *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, Promo Print Publishing House, Korçë 2016, f. 623.

² Gj. Shkurtaj, Pasqyrë madhështore e leksikut dhe e frazeologjisë shqipe të krahinës së Devollit (Rreth librit “Fjalor leksiko-frazeologjik i Devollit” i prof. dr. Ali Jasharit), në A. Jashari, *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit*.

pasqyruar, por që, në vetvete, janë dhe mbartës të pasurisë gjuhësore popullore. Pra, *vjelja e drejtpërdrejtë e lëndës në terren është një vlerë e spikatur e veprës*. Vepra vlerësohet, gjithashtu, se ka regjistruar pasuri leksikore e frazeologjike dhe nga vepra të shkruara, sidomos nga letërsia folklorike e zonës. Autori, me formim profesional të lartë, ka ditur çfarë e si të vjelë prej kësaj letërsie, çfarë të qëmtojë e çfarë të përzgjedhë (në një kohë kur botimet e sotme si fjalorë të këtij lloji synojnë të pasqyrojnë gjithçka që gjallon në të folmet dialektore e krahinore) dhe duke e parë gjithçka si marrëdhënie *pasuri leksikore dialektore / pasuri kombëtare*.

Me të drejtë Gj. Shkurtaç shkruan se “Për vlerat dhe prurjet e freskëta, sidomos për pasurinë e madhe të fjalëve dhe frazeologjizmave të Devollit, vepra *“Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit”* plotëson një njohje të gjerë e të munguar të pasurisë leksikore e frazeologjike të njërës prej krahinave më tipike të Shqipërisë së Jugut. Ai radhitet, pa dyshim, krahas fjalorëve më të mirë të shqipes së sotme dhe të fjalorëve krahinorë, duke u bërë një dëshmi e shkruar e fjalës që gjallon në gjuhën e folur, sepse, kur fjala e gjallë zë vend në një fjalor, është e sigurt që nuk ka për t’u harruar sa të jetë vetë populli që e flet atë.”³

2. Vepra *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit* ngërthen në faqet e tij një pasuri të madhe njësish, rreth 13.000 zëra leksikografikë. Akademik Gj. Shkurtaç, në një vështrim të thukët e tepër informues, shkruan se “ky Fjalor na vjen në dorë me një vëllim të bëshëm prej plot 623 faqesh, ku përfshihen rreth 13000 fjalë, njësi frazeologjike, emra njerëzish, emërvende, fjalë të urta, proverba, urime, mallkime, eufemizma etj., me një paraqitje shumë të hijshme teknike e tipografike, me pamjen që tregon zbatimin e teknologjisë bashkëkohore të leksikografisë moderne, me theksimin e lemave me ngjyrë të kuqe, po edhe me shpjegime të qarta e shembullzime të gjetura më së miri (përmbi 7 mijë mikrokontekste nga gjuha e folur e popullit, si dhe nga veprat e shkrimtarëve e poetëve nga Devolli) e me plotërinë e larminë më të lakmueshme për një vepër këso dore.”⁴

3. Vepra sendërton një punë të madhe, pasionante e të lodhshme jo vetëm me shtrirje të madhe kohore (si mund të thuash një *opera vita* e autorit), por dhe një punë skrupuloze shkencore leksikografike, që përmbush të gjitha kërkesat dhe kriteret bashkëkohore në fushën e leksikografisë shpjeguese me të gjitha fushat: njësia që ka zënë vend në

³ Gj. Shkurtaç, *po aty*, f. 11.

⁴ Gj. Shkurtaç, *po aty*, f. 10-11.

fjalor është qëmtuar me kujdes, duke u pajisur me të gjithë elementet plotësuese, që të çojnë në përkatësinë leksiko - gramatikore dhe treguesit e tjerë që fytyrojnë elementet kryesore eptimore. Madje, siç cituam më lart nga Gj. Shkurtaç, ka përdorur teknika leksikografike që e bëjnë veprën shumë miqësore me përdoruesin.

4. Fjalori përveçohet dhe në një kahe të tjetër: njësitë leksiko-frazeologjike në faqet e tij janë vjelë në sistem, sidomos në lidhjet semantike e fjalëformuese. Autori ka ditur të kërkojë me kujdes e profesionalizëm nga subjekti, prej të cilit vilet a merret pasuria gjuhësore (fjalë, frazeologji, kuptime të reja, përbërës të rinj kuptimorë, toponime, oronime etj.) dhe të plotësojë zbrazëtitë që mund të dalin në vargjet a në paradigmën e larmishme fjalëformuese, duke iu drejtuar jo mundësisë plotësuese prej gjuhëtari (plotësimi subjektiv dhe a priori), por duke iu drejtuar subjekteve folëse për ta gjetur fjalën e munguar te gjuha e popullit dhe jo tek aftësia vetjake krijuese e leksikografit.

5. Dihet se një vepër leksikografike nuk del vetëm si regjistruese e pasqyruese e një pasurie të caktuar, por mbi të mund të ndërmerren studime të shumëfishta. Dhe, aq më shumë, kur në duar ke vepra të tilla që lidhen me pasurinë leksikore, frazeologjike, semantike etj. të një areali të caktuar gjeografiko - gjuhësor. Këto hapësira studimi i mundëson dhe vepra *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit*. Studimet mund të jenë të rrafshit sinkronik, që lidhen me dukuri të morfologjisë së fjalëformimit (kemi tipa të ndryshëm fjalëformues), me morfologjinë e eptimit (forma interesante të lakimit apo të zgjedhimit të ardhura përmes jetës së fjalëve me shembuj nga më të larmishmit), me dukuri të fonetikës së sotme e sidomos të fonetikës dialektore, me dukuri të historisë së shqipes e të popullit shqiptar (aty gjen shumë huazime, ndër to shumë turqizma); me elemente të etnokulturës e besimeve fetare (mjafton të ndalesh në onomastikë dhe mund të hartosh një studim të veçantë për emrat e besimit myslimano - bektashi, për emrat e njerëzve sipas traditës së besimit ortodoks, emrat e njerëzve sipas profesionit, sipas një tipari të relievit gjeografik etj.).

Ne jemi ndalur në vijim në këto hapësira, duke skicuar punime të ardhshme për to.

6. Një vepër leksikografike, në pamje të parë, mund të vlerësohet për nga vëllimi dhe sasia numerike e zërave që pasqyron në faqet e veta, d.m.th. mund të vlerësohet për makrostrukturën. Mjafton të ripërmendim se në *Fjalorin leksiko - frazeologjik i Devollit* kemi rreth 13.000 zëra (si fjalë tituj), shumica dërmuese e të cilëve i përkasin pasurisë leksikore

(zëra leksikografikë si fjalë leksikut të përgjithshëm apo atij të veçantë)⁵ dhe pjesa tjetër pasurisë që lidhet me fusha të tjera gjuhësore dhe të etnokulturës.

Kjo pasuri kaq e madhe mund të vështrohet më fthillueshëm.

Është e kuptueshme që në një fjalor krahinor shtresa e *leksikut të përgjithshëm* do të zërë vendin kryesor. Edhe në veprën që kemi në duar, Ali Jashari sjellë lëndë të shumtë për këtë shtresë, duke dhënë njësi leksikore zakonisht të pambledhura më parë (madje edhe njësi të panjohura a pak të njohura në areale të tjera gjuhësore të shqipes) ose që njësi nuk kanë zënë vend në fjalorët shpjegues kombëtarë, si:

babíc/ë,-a f. gjilpërë e madhe për të qepur rroba të trasha; babushkë: *Isha i thekur pas bagëtime. Dija t'i grazhdoja e t'ua kruaja bajgat me krehërin e drunjtë, t'u vija samarin dhe t'u qepja palldëmet e qenglat me babicën e dysheqeve.* (A. Andoni, N)⁶.

(h)úçk/ë,-a f. dru i hollë me majë që ngulet pranë bimëve për të mbajtur trupin e tyre drejt, kur rëndohen nga frutat: *toka rrotullohet rreth një huçke, që ka vlerë po aq sa otreshi.* (H. Lilo, O). ❖ *huçkë bë huçkë gjersa i hyri huçka dë bythët - thjeshtligj.* e pësoi ngaqë nuk rrinte në një vend (për një fëmijë të lëvizur).

shurígë /ë,-a f. 1. lloj toke me rërë: *dëbora binte me flokë të mëdha duke e trashur jorganin e saj mbi barin e përbrymur, mbi djerrinat e shurigat.* (T. Laço, M). 2. mb. që rritet në tokë me rërë: *patate shurigë.*

shurovín/ë,-a f. shurigë, tokë me rërë.

Por në *Fjalorin leksiko - frazeologjik i Devollit* ndeshim jo pak njësi leksikore të njohura, madje me shtrirje mbarëkombëtare, të cilat autori i ka futur në të për pasurinë përdalluese që sjellin (nuanca kuptimore, njësi frazeologjike, fjalë të urta, pasuri toponomastike etj.). Fjala vjen, autori e ka parë të arsyeshme të sjellë njësi si emrat *arë, brez, gojë, kokë, mustaqe, lesh, nepërkë opingë* etj. Kështu, ai nuk ndalet në strukturën kuptimore të fjalës *lesh* (jep vetëm sinonimin *flokë*), e cila në të gjithë fjalorët shpjegues del shumëkuptimëshe, por i jep përparësi pasurisë frazeologjike (ku gjejmë njësi të mbarë shqipes, si dhe ato që gjenden në arealin gjuhësor të Devollit):

⁵ I mëshojmë këtij aspekti, sepse në vepër, siç kemi pohuar, gjenden dhe zëra të tjerë leksikografikë që lidhen me onomastikën, toponomastikën etj.

⁶ Shembujt janë dhënë sipas Bibliografisë së veprave të vjela dhe shkurtesat e tyre f. XV-XVIII në *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*.

lesh,-i m. flokë: *Ke burrin asker Janinë / o, moj Rinë / dërgoi kartë të vijë! / në të thënë për në vjeshtë/ mblidhi shoqet shkuro leshtë.* (K. Zdruli, FDS) ♦ *e bëri lesh arapi* (një punë etj.) - e ngatërroi keq. ♦ *u bë si leshi bë furkët* dikush - u dobësua shumë. ♦ *i ra leshtë e bythës* dikujt - thjeshtligj. u plak, nuk ka më fuqi. ♦ *i ka rënë leshtë e kokës* dikujt - iron. ka studiuar shumë, ka përvojë të gjatë në një punë. ♦ *kur ta dërsilëm leshtë - keq.* kurrë, asnjëherë; kur të qethen viçat. ♦ *po dredh leshtë* dikush - keq. rri kot, nuk bën asnjë punë. ♦ *ka ikur për lesh* dikush - thjeshtligj. nuk është mirë nga mendtë; bën veprime të pamenduara mirë. ♦ *do t'i jepja lesh, po s'i shita delet - tall.* thuhet për dikë që lakmon shumë, që hyn ku s'ka asnjë mundësi. ♦ *i ka leshrat korije* dikush - është me flokë shumë të dendur. ♦ *la leshtë e barkut (e bythës)* dikush - harxhoi a pagoi shumë për diçka. ♦ *s'la lesh bë kokët* dikush - i shkuli flokët ngaqë i ndodhi diçka e keqe. ♦ *mori leshtë e balikut (e balos, e barkut, e Cures, e Marikës)* dikush - keq. nuk mori asgjë, mbeti me gisht në gojë. ♦ *lesh me qime - thjeshtligj.* gjë e kotë; që s'ka asnjë vlerë. ♦ *lesh me qime, moj Fatime - thjeshtligj.* lojë fjalësh. ♦ *me një lesh të tjerë vesh tre asqerë* dikush - tall. thuhet për dikë që s'ka shumë dhe mundohet t'u bëjë hatër të gjithëve. ♦ *e peshon leshin pa qethur dhentë* dikush - është shumë i nxituar. ♦ *shkoi për lesh e erdhi i qethur* dikush - dështoi në një punë; i harxhoi të gjitha ato që do të përdorte për të fituar. ♦ *lesh bë tresh, se bë katërsh bëhet fanellë* - nuk më mjafton diçka, pa dija unë ç'të bëja.

(h)ukás fol. 1. fryj duart për t'i ngrohur: *U nis drejt stallave atë mëngjes dimri, duke u mbajtur pas gjerdeve të rrugës dhe duke sharë "Siberia e m.. m.. utit" e hukiste duart e ngrira.* (A. Andoni, T). 2. lëshoj ajër të ngrohtë nga goja: *Kurrizi preku murin e lëmuar të ahurit dhe dhia ia afroi turinjtë që hukatnin mbi të sajën.* (A. Andoni, N).

Më tej po ndalemi në disa nënshtresa të leksikut të përgjithshëm, ku sendërtrohet një pasuri e vyer dialektore e kombëtare dhe një punë e kujdesshme e profesionale e hartuesit të veprës.

6. 1. Leksiku konkret

Leksiku konkret përbën nënshtresën kryesore të leksikut të përgjithshëm, e kushtëzuar shpesh dhe nga mënyra e vjeljes dhe objekti i vjeljes në terren.

pét/ë,-a f. gatesë brumi e tërhollur me petës në jastragaç: - *Moj babo, ç'bën atje?/- Bënj një petë me armé.* (Koçillari, TShD); - *E kishte shumë qejf atë të uruarin mish me petë.* (S. Hoxhalli, F). ♦ *petë bakllavaje*- shumë e hollë, shumë e tejdukshme. ♦ *e bëri petë* dikë-e shtypi, e plloçkosi. ♦ *s'bëhen petë me miell misri*-thuhet për diçka të pamundur. ♦

e dredh si petën bë jastragaçt dikush-është dredharak. ❖ *të than petën* dikush-iron. 1. është hamës i madh. 2. është hajdut i stërvitur

krunde v. sh. 1. lëvozhgat që dalin kur bluhet gruri; hime. 2. *fig. keq.* njeri bosh, pa mend: *E lanë Qenam bej Orhanë me ca krunde që s'i hanin as pulat.* (D. Agolli, NjK). 3. *fig* shumë i varfër: *Më premtoi se do më varë në qafë një kryq floriri, por unë nuk e besoj këtë. Është krunde, xheshpuar.* ((Th. Naqo, PI).) ❖ *me krunde s'bëhet byrek* - fj. u. për të bërë një gjë duhen mjetet e duhura. ❖ *kapet pas krundeve* dikush - merret me gjëra të vogla e pa shumë rëndësi. ❖ *ka mbetur krunde* dikush - është në gjendje të keqe ekonomike. ❖ *po të përzihesh (të ngatërroresh) me krunde, të hanë pulat* - fj.u. mos u merr me gjëra të vogla.

6.1.1. Leksiku që lidhet me emërtime bimësh

Autori është munduar që të përfshijë në *Fjalor* thuajse gjithë emërtimet për bimët që rriten në Devoll e rrethina. Po japim më poshtë disa emërtime për peme, barishte etj.

mollëdhéu f. bimë në formën e patates, kokrrat e së cilës kanë shije të mirë dhe mund të hahen të papjekura a të paziera: *sekua do të të sjellë qersh, mollëdheu, lajthi.* (S. Andoni, MSh).

anúrکہ,-a f. lloj molle me lëvore të kuqe dhe e ëmbël: *dhe në këtë vjeshtë të mbarë, mollët anurka kishin lëshuar lule për së dyti.*

labót,-i m. bar i keq me gjethe të gjera: *vendi tani vinte shurigë e thatë dhe gjëkund nuk dukej bar nga ata që hanin derrat: radhiqe, burdullak, labot apo manakuq.* (Th. Jorgji, PD).

(h)íthk/ë,-a 1. hithër. 2. *mb. fig. keq.* që flet me ironi. ❖ *është hithkë nga goja* dikush - flet me thumba.

trósk/ë,-a f. 1. bimë rrënjore zvarranike që bëhet nëpër ara dhe dëmton bimët e mbjella: *U mundua të fshihte në opinga me qafat e çorapeve të grisura thembrat e këmbëve që nxinin nga troska.* (A. Andoni, GML). 2. *fig.* i ndyrë, i papastër.

6.1.2. Leksiku që lidhet me emërtime kafshësh

Kuptohet që dhe emërtimet e përgjithshme për kafshë do të kishin vendin e tyre në *Fjalor*. Edhe për këtë nënshtresë të leksikut të përgjithshëm po japim 3-4 zëra ilustrues:

balásh,-i m. 1. ka me pullë në ballë. 2. shpend uji me pupla të zeza e të bardha, që ushqehet me peshk. 3. *mb.* që ka pullë të bardhë në ballë: *prapa asaj korije/ ljepuri ndën hije/ ljepuri murrash-e/ dë ballët balash-e.* (K. Zdruli, FDS). ❖ *ka balashi dhjamë* - thuhet me shaka për dikë që të tjerët e dinë të pasur, por në të vërtetë nuk është ashtu. ❖ *e përqesh balashi* - i duket sikur e tallin të tjerët.

baláshk/ë,-a f. lopë me një vijë të bardhë në kokë: *polli balashka; e moli balashkën.*

baldós/ë,-a f. 1. lloj kafshe me lëkurë të trashë e të dhjamur; dosëbalë. 2. keq. femër e shëndoshë jashtë mase.

zhábk/ë,-a f. zhabë e vogël.

Në vepër shumë emërtime për kafshë e për bimë kanë strukturë kuptimore polisemike, duke u bërë tregues të zgjerimit të aftësisë shënuese të këtyre emërtimeve. Shpesh si kuptime të dyta dhe të treta (a më tej) dalin tashmë lidhje që na çojnë jashtë fushës nocionore / konceptore të botës së kafshëve e të bimëve. Po ilustrjmë:

jariçk/ë,-a f. 1. ariçkë; zogë që bën vezë që motin e parë, zogu i vogël i pulës: *Tiganisa mbrëmë një jariçkë që ta kisha për sot, mirëpo ke parë ti që ajo ka harruar të ma verë në torbë?* (T. Laço, PK). 2. fig. vajzë e porsamartuar: *Ç'kërkove q'erdhe këtu/ moj jariçk' e bardhë!/- Kërkoj nënën dhe babanë/ kërkoj motrën dhe vëllanë!* (K. Zdruli, FDS).

kukumjáçk/ë,-a f. 1. kukuvajkë, lloj shpendi grabitqar i natës, që ushqehet me zogj a me minj dhe lëshon një zë sikur vajton (edhe si gjymtyrë emërvendi: *Stena e Kukumjaçkës*): *Thëngjilli i vatrës/ trembi zërin e kukumjaçkës/ u bë ledhatim!* (N. Morava, F). 2. fig. grua pa burrë e pa fëmijë: *Mbeti kukumjaçkë e bija.* ❖ *i këndon kukumjaçka bë çatit* dikujt - sipas besimit popullor, atu ku këndonte kukumjaçka do të ndodhte patjetër një fatkeqësi.

zhabják,-u m. 1. hardhucë e madhe: *Kishte zhabjakë nëpër tullat e thyera, po as që pyesja për këto.* (S. Andoni, TN). 2. fig. që ka ngjyrën e zhabjakut, që ka ngjyrë të gjelbër: *Dukeshin ca karvanë të huaj, të gjelbër si zhabjakë.* (S. Andoni, MSh).

úlk,-u m. 1. ujë: - *Në mos erdhtë edhe tashinë/ do të marr t'i djeg shtëpinë/ do t'ia bëj shesh e lëndinë/ të lozë macja me minë/ edhe ulku me arinë!* (K. Zdruli, FDS). 2. diçka e keqe: - *Dita është e mirë, pa nata! Ulk, pe vërteti.* (A. Andoni, N). ❖ *të çaftë ulku pa dhëmbë (me brirë)!-mallk. tall.* paç vdekje të mundimshme. ❖ *s'e ha ulkun (fare)* dikush -tall. nuk e ka qejf punën, nuk është i zoti për punë. ❖ *s'ha ulku mish bë porosi-*thuhet me ironi për dikë që e do gati çdo gjë. ❖ *si ulku dë kollozhegt-i* pangopur; në gjendje të keqe ekonomike. ❖ *lot ulku me arinë* 1. është shumë ftohtë; fle macja me miun. 2. është rrëmujë e madhe, s'e merr vesh i pari të dytin. ❖ *s'trembet ulku nga këmborët-njeriu* i keq nuk do t'ia dijë vetëm me fjalë. ❖ *s'i varen ulkut mëlçitë (zorrët) bë qafë-*është njeri që nuk i zë dot besë. ❖ *unë them ulku ti gjurmët-* i thuhet dikujt që nuk kupton.

6.1.3. Leksiku që lidhet me emërtime për insekte etj.

Edhe për këtë nënshtresë leksikore apo grup paradigmatic njësisht leksikore gjejmë disa emërtime në Fjalor:

(h)undëgját/ë,-i m. lloj insekti dëmprurës që ha kokrrat e panxharit nën tokë; quhet kështu se e ka hundën të gjatë: *Shumë vetë e ngatërruan refugjatin me hundëgjatin që dëmtonte panxharin. Një brigadier, duke sqaruar situatën para punëtorëve, tha: "Le të ikin, le të ikin, se në një kamp me hundëgjatë i kanë mbyllur! Se hundëgjati ia ha t'ëmën panxharit, jo njeriut!"* (H. Lilo, O).

buburísk/ë,-a f. 1. nuse pashke, parashkëndi, që, sipas besimit, sjell lajme të mira: *Buburiskë e malit, shko na merr dainë.* (K. Zdruli, FDS); *Kishte një fustan me pika me ngjyrën e buburiskës.* (D. Agolli, TG). 2. mb. përk. e urtë, e qetë: *është si një buburiskë.*

6.1.4. Leksiku që lidhet me emërtime veshjesh

Emërtimet për veshjet (për burra e për gra, për fëmijë e për të rritur, për jetën e përditshme e për ngjarje të veçanta etj.), po ashtu kanë zënë vend në Fjalor. Megjithatë ato, numerikisht, mund të formojnë një grup të vogël, kanë interes gjuhësor e jashtëgjuhësor. Si do të shihet në vijim, aty mund të gjejmë lëndë për të studiuar dukuri të historisë së gjuhës shqipe, dukuri fonetike, morfologjike etj., krahas atyre leksiko-semantike.

anterí,-a f. lloj veshjeje prej stofe a ndonjë cope tjetër që gratë e mbajnë për të fjetur; këmishë nate; lloj jeleku pa mëngë: *Pa do të të sjell një anteri të bukur...* (S. Andoni, MSh).

fjónçk/ë,-a f. fjongo e vogël: *i vuri një fjonçkë bë kokë.*

fustané,-ja f. fustanellë: *Fustanenë korbë që të djalërisë / dridhe, Malo, dridhe kazan' e Ohrisë!* (Koçillari, TShD).

fustanéll/ë,-a f. fund me pala i veshjeve popullore. *Me dy fjalë rrëfen ç'erë e mbarë e solli, futi fustanellën nën hejbe e u nis rrëmbyer, siç pat ardhur.* (T. Laço, PK).

fustánk/ë,-a f. fustan i vogël: *Moj e holla porsi bari / e kulluara si ari/ vishe, moj, fustankën / vishe, moj kollankën.* (K. Zdruli, FDS).

fúst/ë,-a f. këmishë e brendshme për gra që përdoret për të fjetur.

(h)ój/ë,-a f. shirit me fije pambuku i bërë me grep që vihet si zbukurim në anët e këllëfit të jastëkut, çarçafit: - *Kush qëndiste, kush bënte hoja me grep, kush thurte fanellë me shtija.* (Th. Jorgji, PD).

xibún,-i m. *etnogr.* veshje grash prej shajaku të zi, i qëndisur në pjesën e përparme me fije ari, ndërsa poshtë dhe anash me gajtan të kuq: *Saba më saba, ti më dej ngaj lumi/ vallë tudesh vetë a të tund xibuni?* (K.

Zdruli, FDS); *K'to nuset e Dardhës veshur me xibuna/ ç'e shkuan të ritë e jetën pa burra!* (Koçillari, TShD).

6.1.5. Leksiku që lidhet me emërtime gatimesh, enësh etj.

Edhe për këtë nënshtresë gjejmë shumë emërtime, me përhapje krahinore a kombëtare, që tregojnë për jetën materiale të banorëve të zonës së Devollit me rrethinat:

dhallaník,-u m. gatesë me shtresa petësh, të cilat bëhen me miell misri dhe me dhallë: *U mënoftë mynafiku/ që tha për Hasanë "iku"/ do na vinte gjalpaniku/ e na dolli dhallaniku.* (Koçillari, TShD). ♦ *prit të skuqet (të bëhet) dhallaniku-tall.* thuhet për diçka që nuk mund të bëhet shpejt; prit gomar të mbijë bar.

laktór,-i m. gatesë brumi me dy petë dhe me gjellë brenda: *Ma bëje lakrorë / Përsipër të djegur / Kush t'i prishka mendtë / Gështenjë e papjekur.* (D. Agolli, ShGh). ♦ *lakror me dëborë* - diçka që s'bëhet. ♦ *lakrorin që s'e ha për vete le të digjet megjithë saç* - thuhet për dikë që sheh vetëm interesin vetjak, që s'pyet e s'mendon për të tjerët. ♦ *është si lakror i pjekur bë djellt* - i papjekur mirë. ♦ *e nis lakrorin nga mesi dikush - tall.* nuk e fillon mbarë një punë.

kabuní,-a f. ëmbëlsirë me oriz, sheqer të djegur e rrush të thatë.

Edhe në këto emërtime mund të shohim zhvillime të brendshme kuptimore (zhvillime polisemike), që dalin jashtë fushë konceptore të gatimeve. Po ilustruam me fjalën *kaçamak*, kuptimi i dytë i së cilës mbart shndërrime të figurshme të kuptimit të parë:

kaçamák,-u m. 1. mëmëligë, mëmëliqe: - *Ç'janë dy djem nga Piluri / venë e vinë dë mulli / të na bluajnë mjell të ri / të na bëjnë revani/ revani e kaçamak / ujë shumë e gjalpë pak.* (Koçillari, TShD). 2. *fig.* përzierje, diçka e ngatërruar: *Mos i bëj të folmet kaçamak, Ildi, - e tallja unë.* (T. Laço, TSh).

bakráçe v. sh. enë prej bakri: *Nga trarët e qilarit u shkund pluhuri. U rrëzuan bakraçet e varura nëpër gozhdë.* (T. Laço, M).

6.1.6. Leksiku që lidhet me emërtime për zeje, vegla pune, procese pune etj.

Një nënshtresë tjetër leksikore që ka zënë vend në Fjalorin e A. Jasharit, është dhe ajo që ka të bëjë me emërtimet për zejet e zejtarinë në krahinën e Devollit. Dhe këtu kemi njësi me vlerë më shumë se krahinore. Një pjesë e madhe e tyre janë formuar përmes metaforizimit (shih në vijim *kulaç* etj.)

babíc/ë,-a f. gjilpërë e madhe për të qepur rroba të trasha; babushkë: *Isha i thekur pas bagëtime. Dija t'i grazhdoja e t'ua kruaja bajgat me*

krehërin e drunjtë, t'u vija samarin dhe t'u qepja palldëmet e qenglat me babicën e dysheqeve. (A. Andoni, N).

lés/ë,-a f. 1. vegël bujqësore për të thërrmuar e rrafshuar tokën e lëruar. 2. thurimë për të mbyllur gardhin: *Bëri mirë, se pak më tej, në lesën që mbyllte një kasolle prej kashte nga ato që ngrenë për të ruajtur bostanët.* (T. Laço, PK). 3. ndajf. shtrirë, në gjendje të sëmurë. ❖ *u bënë lesë* - janë sëmurur të gjithë (nga gripi a një sëmundje tjetër). ❖ *i bëri lesë* - i vrau të gjithë, nuk la asnjë më këmbë. ❖ *e zë lesa dikë* - bie shpejt në kurth, në grackë; nuk është hileqar e dinak.

kuláč,-i m. pjesë e zgjedhës që përdoret për të mbrehur qetë: *Ngriti ngadalë pjesën e fundit të shtratit të topit dhe e lidhi me litar në kulaçin e zgjedhës.* (D. Agolli, NjT).

6.1.7. Leksiku që lidhet me emërtime për lojëra popullore

Një numër i vogël emërtimesh, që i gjejmë në faqet e Fjalorit, është dhe ai për lojërat popullore, që lidhen, së shumti, me botën e fëmijëve, por pa munguar dhe ato për të rritur.

kóčk/ë,-a f. lojë fëmijësh: hapej një gropë e vogël ku do të hidhej koçka, një copë dru sa një tapë e madhe dhe rreth saj bëheshin tri bica (gropa të vogla), sa të futej thembra e këmbës. *Tre fëmijë, me thembrën e këmbës vënë në bica, tundnin nga një shkop sipër gropës për të mos lënë koçkën të futej dhe i katërti përpiquej të hidhte koçkën në gropë. Në disa fshatra të tjerë të Devollit kjo lojë quhet "kotelkë".*

(h)apadollápa v. nj. emër i një loje fëmijësh, kur dikush i mbyll sytë dhe e thotë këtë fjalë me qëllim që të mos i rrijë tinëz prapa shpine: *Hapadollapa, kush të jetë prapa, unë sytë i hapa!*

strěqk/ë,-a f. 1. lloj lodre që bëjnë fëmijët prej drurit të shëlgut, pasi ia heqin palcën; brenda tij futet një shkop me leckë në majë që shërben për të thithur ujin në enë dhe, duke e shtyrë përpara, fëmijët lagin njëri-tjetrin: *më parë fëmijët lonin me strëqka.* 2. pikë uji: *S'është hiç turp në zallishte/pulpëbardhoshe mbi aliçë/ u puth gjinjtë fllad' i lumit/ spërkat sfrati me strëqka uji.* (Th. Naço, ÇMB). 3. pellg i vogël uji: *Lumi vinte nga shteti tjetër, në një grykë të ngushtë, këtej zgjerohej në ca plloça, kalonte strëqkën plot me cirona të ndryshme dhe hynte prapë andej.* (H. Lilo, D).

yzýk,-u m. lloj loje me filxhanë kafeje që e luanin 6-10 vetë të ndarë në grupe, ku filxhanët viheshin përmbys dhe në njërin prej tyre fshihej një unazë, një kopsë etj. Kush nuk e gjente i pari, dënohej duke i vënë në ballë buzët e filxhanit të lyer me thëngjij: *Burrat, duke ngrënë patate, luanin zzyk.* (H. Lilo, D). ❖ *lozin zzyk* - keq. e kalojnë kohën kot.

6.1.8. Leksiku që lidhet me emërtime sëmundjesh

Dhënia e emërtimeve për sëmundje të ndryshme që prekin njerëzit apo kafshët, madje edhe bimët tregon edhe një herë karakterin sistemor të grumbullimit të leksikut në terren nga studiuesi Ali Jashari, si dhe vjeljen me pikësnyime të qarta e në plotërinë e fushave tematike të emërtimeve që lidhen me jetën materiale shpirtërore të banorit devolli.

tartakút,-i m. 1. sëmundje e kuajve: *Mos i hyr në hakë, se do të të dërgojë Zoti ndonjë tartakut, që të të shkundë!* (Th. Jorgji, PD). 2. *fig.* frikë e madhe. 3. i ftohtë i madh: *i hyri tartakuti*. ❖ *tartakut me bojë* - keq e më keq. ❖ *të marrtë tartakuti!* - mallk. vdeksh! ❖ *e zuri tartakuti dikë* - u tremb shumë.

dam(b)llá,-ja f. damlla, sëmundje e rëndë që vjen nga gjakrrjedhja në tru ose nga mpiksja e gjakut në enët e trurit dhe që shkakton menjëherë humbjen e ndjenjave dhe pushimin e lëvizjeve, pikë: 2. *fig.* fatkeqësi e madhe a goditje e rëndë dhe e papritur. ❖ *i ra damblaja* dikujt - keq. vdiq, shkoi me të shumtët. ❖ *të rëntë damblaja!* - mallk. vdeksh!

6.2. Leksiku abstrakt / mundësor

Sistemësia dhe simetria e mbledhjes së pasurisë leksikore e semantike në arealin gjuhësor të Devollit duket drejtpërdrejt dhe në leksikun abstrakt. Kjo shtresë me një numër të vlerësuar njësisht tregon dhe një herë punën profesionale të studiuesit Ali Jashari. Ai ka ditur të dalë nga “gracka” e mbledhjes së pasurisë në terren, kur shumë mbledhës rendin apo janë të prirur për të sjellë leksik konkret dhe me fusha tematike (leksiko-semantike) të paracaktuara.

babaxhán,-i m. 1. njeri shpirtmirë, që nuk di t’i bëjë keq kujt, i njerëzishëm, i dashur: Të gjithë ia dhanë gazit, veç atij që quhej Zenel, një burrë me pamje prej babaxhani. (T. Laço, P). 2. njeri i shëndoshë dhe i fuqishëm: *Mblidhen burrat përmbi urë / harruan lopët arat me grurë/ babaxhanë – mëngëpërveshur / ç’thotë graria veshëngrehur!* (Th. Naço, ÇMB). 3. *fig.* gjë e stërmadhe: - *Këtë babaxhan ne do ta tërheqim nëpër korije dhe do ta fshehim.* (D. Agolli, NjT).

babëzi,-a f. pangopësi, lakmi, uri e madhe: *Burri, duke thithur me babëzi cigaren, ndjeu t’i ngatërroheshin të gjitha.* (T. Laço, P).

mejtój fol. mendoj, vras mendjen për të vendosur për diçka: *Tërë i mejtova/ për ty s’më vjen keq.* (Koçillari, TShD); - *Si s’më la babai, nëne, të mejtohem/ u bëra pishman që do të martohem.* (K. Zdruli, FDS).

mejtúar (i, e) mb. që e vret mendjen, që bluan në mendje: *Sytë e mejtuara të babait nuk do t’i shihte më kurrë.* (S. Andoni, TM).

urtóhet fol. e merr uria: *Kishin punuar një lëmë vend dhe u urtuan për bukë.* (H. Lilo, KMK).

tapinós fol. e bëj të urtë e të sjellshëm.

6.3. Leksiku i veçantë

Koncepti *leksik i veçantë* është shumë i gjerë dhe përfshirës. Ne po ndalemi shkurt vetëm në një shtresë leksikore, në grupin e emërtimeve që i përkasin leksikut për botën fetare:

jací,-a f. falja e mbrëmjes; lutja që bëjnë besimtarët myslimanë një orë e gjysmë pas perëndimit të diellit: *I zoti i kësaj shtëpie/ s'na ther as gjysmë dhie/ veç një lugë janie/ dhe një çorbë jacie.* (Koçillari, TShd).

barjám,-i m. bajram, kështu quhet secila nga dy festat fetare të myslimanëve (*Barjami i Madh; Barjami i Vogël*): *Ditën e barjamit preva një fustan/ Me gërshërë e preva, me lot po e lanj.* (Koçillari, TShd).

mullá,-i m. hoxhë që jep mësim në medrese: *Një ditë në mësim të historisë/ m'u shkrep të bëja bejthe për mullanë/ "Mulla, ti ia nxjerr fundin revanisë/ kur ne të tjerët s'kemi se ç'të hamë.* (D. Agolli, P).

6.4. Leksiku i vjetruar

Përgjithësisht këtu mund të përfshihen njësi leksikore që janë huazime nga turqishtja, të cilat në leksikun dialektor përfshihen në leksikun aktiv. Kjo veçori lidhet me një prerje diastratike, sepse, më së shumti, ato ndeshen në ligjërimet e të moshuarve sesa në ato të të rinjve. Gjithashtu, një pjesë prej këtyre njësive janë vjelë nga letërsia e shkruar që trajton tema të historisë së krahinës a më gjerë.

agá/i m. 1. pasanik, pronar tokash. 2. emër me të cilën e thërriste nusja vjehërrin: *erdhi agai; si e ke again.* 3. keq. ai që është i prapambetur, i paarsimuar: *na mbytën agallarët; u mbush qyteti me agallarë.* 4. fig. trimi: *Qante një turkez e bukur/ po na qanë për aganë/ Fora Marko, jataganë.* (H. Koçillari, TShd). ❖ *një herë agaj, një herë ustaj-keq.* barabar, pa mbajtur anën e askujt; me drejtësi.

agabé,-u m. emër me të cilin e thërriste gruaja vëllain e burrit.

kuvét,-i m. shëndet.

kumandár fol. 1. rregulloj, përgatit: - *Të qënkam lagur këmbët, o çupë; do t'ju kumandar, o bij, me duar e zemër prej nëne.* (S. Andoni, TM). 2. iron. e bëri gati, e veshi etj., për në botën tjetër: *Priftin e kishte marrë inat qëkurse kishte "kumandarur" për në botën tjetër plakën e Nicës.* (A. Andoni, N).

kajmekám,-i m. zyrtar i lartë në kohën e sundimit osman, nënprefekt: *Hysenaj me pallë/ ngriti mexhilisnë/ ngriti kajmekamnë.* (Koçillari, TShd).

teftër,-i m. 1. defter, fletore. 2. regjistër i kadastrës, i gjendjes civile etj.: Vajti e hapi tefterin e madh të gjendjes civile. (S. Andoni, MSh). ❖ *ka dalë nga defteri* dikush - nuk është në rregull, sillet a vepron keq. ❖ *e fshiu (e hoqi, e nxori) nga tefteri* dikë - nuk e përfill, nuk merret më me dikë. ❖ *tefter hallbaxhiu* - keq. fletore a diçka tjetër për të shkruar që mbahet keq. ❖ *nuk e vë (nuk e fut, nuk e kam) në tefter* dikë - nuk e përfill, nuk e llogarit fare, s'ia var torbën.

teskeré,-ja f. 1. pasaportë: *Teskerenë e nxori, shokët s'e besojnë/ Dil, foli tit biri, ce kërkon të shkonjë!* (Koçillari, TShd). 2. ftesë për dasmë, lajmërim. ❖ *ia dërgoi teskerenë* diku - e lajmëroi (zakonisht për diçka jo të mirë).

6.5. Leksiku i huazuar

Në *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit* pasqyrohen një numër i madh huazimesh. Kjo dukuri lidhet me strukturën leksikore të folmeve të këtij areali gjuhësor, çka vërehet dhe në dhjetëra fjalorë dialektorë, të botuar nga mbledhës të tjerë të pasurisë që gjallon në krahina e të folme të ndryshme. Më poshtë po ndalemi në disa nga grupimet kryesore të këtyre huazimeve.

6.5.1. Huazime orientale / huazime turke

Huazimet nga gjuhët orientale e sidomos huazimet turke krijojnë lagjen më të madhe të huazimeve në Fjalor, madje duket sikur prish dhe raportin leksik vendës / leksik i huazuar. Ato u përkasin të gjithë elementeve të jetës materiale e shpirtërore të devollinjve. Pavarësisht kësaj, pasqyrimi i tyre në fjalor ka vlerë të madhe gjuhësore, sepse regjistron një gjendje leksikore të Devollit në një prerje të caktuar kohore. Siç do të shihet dhe më tej, një pjesë e këtyre huazimeve kanë krijuar dhe dhjetëra e dhjetëra njësi frazeologjike:

azât mb. 1. i lirë, që nuk ka asnjë pengesë: *Njëherë Batua kishte lëshuar gomarin azat nëpër livadh ...* (T. Laço, AFM). 2. ndajf. fig. pa fre, pa u menduar: *-Po ç'dreq agjitorit je ti, kur e lëshon gjuhën azat e s'e mbledh dot më?* (T. Laço, P). ❖ *e lë azat* dikë - nuk kujdeset më, e la të bëjë si të dojë.

jaták,-u m. 1. dyshek: *Lodhur në rrugë e çlodhu në jatak.* (D. Agolli, NjT). 2. fig. vendi ku mund të strehohesh e të rrish i qetë; vend i sigurt; mbështetje: *- Në qoftë se me ne kërkon të vish/ jatakun ti këtu e ke të shtruar/ në gjirin e vëllezërve të rrish.* (D. Agolli, P). 3. strofull e lepurit të egër. ❖ *iu bë jatak* dikujt - e përkrahu, e mbështeti.

badjavá ndajf. 1. badihava, falas, shumë lirë: *Qyl ose pa paguar janë mall kooperative, nuk japim badjava ! - tha Mystehaku.* (T. Laço,

PD). 2. pa dobi, kot së koti, në tym. ❖ *flet badjava* dikush - flet kot, pa fakte e argumente.

bylýk,-u m. 1. turmë, grumbull: *Na vinte yzbashi me bylyk eminë/ Vjen të na bastisë Arif Bektashinë.* (Koçillari, TShd). 2. ndajf. fig. të mbledhur bashkë, të ngjeshur shumë pranë njëri - tjetrit: - *Po sikur të na shohin grekët siç jemi bylyk dhe na kthejnë ndonjë top?* (T. Laço, M).

bylykçi,-u m. ushtar këmbësorie: *Të pabesë moraitë/ Vranë të dy bylykçinjtë/ Të dy bylykçinjtë i vranë/ Këshon me llafazanë/ Bylykëtë shkretë i lanë.* (Koçillari, TShD).

iktizá,-ja f. nevojë; urgjencë: ❖ *s'është me iktiza* diçka-nuk është e ngutshme. ❖ *e ke me iktiza?* - nxitohesh, ngutesh?

ilaká,-ja f. krushqi: *Po kish ilaka të fortë me ata të fshatit tjetër.* (S. Andoni, MSh). ❖ *bëjnë (janë) ilaka*-lidhen krushqi. ❖ *ilakaja* ngjan, pa bëhet-fj. u.

6.5.2. Huazime greke

Është e kuptueshme që në Fjalor si pasqyrimi gjendjes në të folmet e Devollit do të ndeshen dhjetëra huazime greke, shumica me shtrirje territoriale të ngushtë, që kushtëzohet nga kontaktet e drejtpërdrejta gjeografike të shqipes juglindore e jugore me të folmet veriore të greqishtes. Dihet se Devolli është rreth kufitar me Greqinë e Veriut. Më poshtë po japim disa huazime të këtij grupi:

afraté mb. 1. e rreptë, e egër: *Kjo ime kunatë/ rrëmben pak m'e gjatë/ po nga duart shpatë/ nga goja afracë.* (K. Zdruli, FDS). 2. shumë i hidhur: *Ishin të tharta e të hidhura si afracë.* (S. Andoni, TV). ❖ *e ka gojë afracë* dikush - keq. është llafazane; të fyen me fjalë të rënda; lëshon njëqind fjalë nga goja.

agurídh/e,-ja 1. m. frutë i papjekur mirë. 2. mb. fig. keq. mendjelehtë, i papjekur, që bën veprime të nxituara: *...Kurse xhaxhai ka dy barrë mend më shumë se ne të gjithë po, ngaqë jeni aguridhe, s'kuptoni dot gjë prej gjëje.* (T. Laço, AFM). ❖ *e ka mendjen aguridhe* dikush - keq. është i lehtë nga mendja; bën veprime të nxituara. ❖ *mbeti aguridhe* dikush - nuk u vuri mend; është ende i papjekur.

molloís fol. 1. rrëfej, tregoj: *Shokët prapa po qeshnin dhe molloisnin ngjarjet e luftës.* (S. Andoni, MSh). 2. mendoj, thur, krijoj: *Të mori e mira, se ç'ka një gaz të paqme dhe një hare ky bumbashiri. Ja, po i gëzohet ishallah të ketë dalë keq ajo mësuesja, vetëm e vetëm që të dalë siç e mollois radakja e tij.* (A. Andoni, T).

moliv/ë,-a f. laps: - *Mos kërkohet pushkë, unë do të të jap një molivë që të shkruash.* (S. Andoni, TM).

thágm/ë,-a f. ngjarje e çuditshme, e habitshme: *Priste sa të ndodhte një thagmë tjetër.* (T. Laço, AFM). ♦ *e bëri thagmë diçka* - e vështirësoi shumë; e paraqiti shumë më keq se ç'është.

kaurdí fol. 1. fërgoj, skuq. 2. fig. edukoj, mbruj: *Bashkë me trupin e tij të dërrmuar nga vojtjet e punës, truri i tij qe bërë qofte e kokodash, shpirti i tij ishte kaurdisur me predikimet e igumenëve.* (S. Andoni, TM).

zografís fol. keq. pikturoj, zbukuroj: *Tashmë valëviteshin flamujt e emulacionit dhe tabelat e të dalluarve të fushatës, që kishte zografisur një nga ata djemtë e fshatit.* (A. Andoni, N).

6.5.3. Huazime sllave

Gjithashtu, në *Fjalorin leksiko-frazeologjik të Devollit* kanë zënë vend edhe sllavizma të ndryshme, të futura në ligjërim më shumë nga kontaktet e hershme historike me pushtuesit sllavë (bullgarë), sesa nga kontaktet e tanishme me popullin maqedonas (si popull sllav).

korít/ë,-a f. govatë: *U ul në një trung të thatë që e kishte sjellë nga korija për ta bërë koritë.* (D. Agolli, NjT). ♦ *hanë dë një koritë* - mospërf. nuk ndahen nga njëri - tjetri. ♦ *ia mbushi koritën* dikujt - keq. e ushqeu me bollëk; nuk i la gjë mangët pa i dhënë.

izvór,-i m. 1. vend ku buron uji nga toka, burim. 2. përrua me ujë që buron nga izvori (edhe si emërvend: *Izvori*): *Izvori në të djathtë kishte shterur me kohë.* (H. Lilo, O).

básht/ë,-a f. copë toke pranë shtëpisë e mbjellë me perime etj.; bahçe (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Bashta e Avdylit; Bashta e Doktorit; Bashta e Qamilit; Bashta e Sefes; Bashta e Shabanit; Bashta e xha Rapos*): *Mu në bashtën tënde/ dyzet rrënjë mollë/ kur u bë kjo çupka/ t'i zërë me dorë!* (K. Zdruli, FDS).

bashtín/ë,-a f. 1. copë toke e trashëgueshme, që e zotëronte një familje në sistemin e timareve. 2. gjendja ekonomike dhe pozita e një mashkulli që vete dhëndër brenda në familjen e nuses dhe jeton e punon aty: *vajti bë bashtinë.*

7. Kuptime “të reja”

Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit ka dhe një vlerë tjetër të shtuar: autori ka ditur të qëmtojë edhe kuptime fjalësh e frazeologjish që dalin si të reja në marrëdhënie me lëndën leksikore e frazeologjike që është botuar deri tani në fjalorët kombëtarë shpjegues të shqipes. Shumë prej këtyre kuptimeve janë dhënë në fjalë të njohura dhe tregojnë zhvillime të brendshme semantike të leksikut dialektor e krahinor.

gjémb,-i m. 1. lloj barishteje që ka në trup zgjatime me majë të mprehtë (edhe si emërvend: *Gjembi*). 2. vegël pune për të mbledhur plehun

e bagëtime: *Anëtarët e brigadës zbritën nga kavaletat e plehut, mbështetën gjembat pas murit dhe hynë në sallë.* (H. Lilo, D). ❖ *nuk i ka hyrë gjembi dikujt* - nuk e ka pësuar asnjëherë. ❖ *s'ka gjemb për këmbë dikush* - është shumë i varfër. ❖ *i kanë mbirë gjembat dikujt* - ka vdekur prej kohësh. ❖ *rri si bë gjemba dikush* - nuk ndjehet mirë.

lapúshk/ë,-a f. fig. kartëmonedhë: *Dhe ato lapushkat e grekut, sa shkojnë akoma në treg, zbrit te sarafët në Korçë dhe ktheji në flori ose në franga.* (T. Laço, M).

teneqë,-ja f. 1. mbulesë metalike për çati: *Do bëjmë shtëpi të re / me plloç' e me teneqe / dale, dale me ngadale.* (K. Zdruli, FDS). 2. mb. fig. i varfër: *Shite lop' e pendë që dhe na mbete teneqe.* (KPRrK). ❖ *ka mbetur teneqe dikush* - është shumë i varfër. ❖ *i rrahën teneqenë dikujt* - e tallën, e vunë në lojë.

múzg/ë,-a f. lloj balte e zezë që ngjitet shumë (edhe si emërvend: *Muzgat; Muzga e Arapit*): *Nevojtorja ishte në fund të oborrit, me mure thuprash ahishte, mbushur me muzgë.* ((Th. Naqo, PI).).

çiftelí,-a f. 1. kurorë flokësh në ballë: *Ajo kishte parë çiftelitë në kokën e tij dhe kishte klithur me tallje: -Iii, dukesh sikur e ke kokën të mbushur me kërmij!* (Th. Naqo, PI). 2. ai që ka kurorë flokësh në ballë: *Nëna i kishte thënë: Çiftelitë martohen me nuskëz të urtë e të bukur që të mbush shtëpinë me kalamaj.* (Th. Naqo, PI).

ballabán-i m. mit. ariu që e shëtisin për të zbavitur njerëzit (edhe si emërvend: *Ballabanët*): *Ç'ka ky sot, sikur i ka ngrënë ballabani brumët? - tha Iliri me vete.* (A. Andoni, T). ❖ *sikur i ka ngrënë ballabani brumët dikujt-i* mërzhitur.

ballabán,-e mb. që është tërë shëndet e me trup të madh: - *Plakë ballabane! - tha Todo Çali që ish afruar.* (T. Laço, M); *Sterjovica në të ritë e saj ishte e gjatë dhe ballabane në trup, tamam dardhare!* (Th. Jorgji, PD).

Madje, në këtë Fjalor gjejmë dhe fjalë të njohura, të dalin me kuptime që nuk kanë lidhje semantike sinkronike me kuptimin e tyre të njohur, duke krijuar kështu deri në marrëdhënie homonimike dhe duke çuar në lindjen e dy njësive leksikore të reja:

Krahaso: **lerishte** f. vend me lerë. (fjalë e mbarë shqipes) dhe nga *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, **lerisht/e,-ja** f. copë toke e papunuar: *Kishin marrë velenxë e jastëkë e na i shtruan mbanë një lerihte, nën një kumbull gjatore.* (S. Andoni, P).

kolovájz/ë,-a f. sh. **-a(t)** lëkundës me një ndenjësë prej dërrase, e lidhur me litarë në një degë peme; shregull, shilarës. (fjalë e mbarë

shqipes) dhe nga *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, **kolovájz/ë,-a f.** hulli në dëborën e ngjeshur në një rrugë të pjerrët, ku fëmijët rrëshqisnin me sane: *Fëmijët rrëshqisnin nëpër kolovajzat e bëra anës përtinje të dëborës.* (S. Hoxhalli, F).

Në Fjalor gjejmë edhe ndonjë fjalë të huazuar që ka ndryshuar kuptimin e parë me të cilin ka hyrë në shqipë. Fjala vjen folja *kleptos* është një huazim nga greqishtja (vjedh). Në fjalor del me kuptim tjetër: **kleptís fol.** ia mbush mendjen një njeriu që të bëjë një gjë që unë i them: - *Andej, këndej, ia kleptisi mendjen Nurja dhe ma nxori.* (T. Laço, TA).

8. Njësi frazeologjike

Studiuesi Ali Jashari e ka quajtur veprën e botuar *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, çka nënkupton se ky fjalor si pasuri kryesore, përveç asaj leksikore, ka atë frazeologjike. Janë me qindra e qindra njësitë e pasqyruara, një pjesë jo e vogël e të cilave gjallon vetëm në krahinën e Devollit. Në hullinë e vlerave të Fjalorit një prej tyre shpërfaqet dhe te shpjegimi i çdo njësie frazeologjike apo i çdo kuptimi të njësisë, kur ajo është polisemike. Teknikisht, njësitë frazeologjike nuk dalin si zëra leksikografikë më vete / si njësi titull (që mund të ndryshonte dhe tipologjinë leksikografike të veprës), por ato jepen si lagje të veçanta pranë gjymtyrës emërore që del si vatrë e tyre kryesore motivuese⁷. Konkretisht: **ÁN/Ë,-a f.** ❖ *ia gjeti anën* 1. dikujt - u lidh me dikë për të zgjidhur një problem. 2. diçkaje - e kreu, e mbaroi. ❖ *s'i gjendet ana* diçkaje - është shumë e vështirë, shumë e ngatërruar. ❖ *hiq nga ana vër bë samart* - thuhet kur bëhet një punë pa frytë. ❖ *s'ka anë e vend* dikush - është shumë i shtrenjtë, shumë i dashur për mua. ❖ *i mbaj anën* dikujt - e përkrah. ❖ *ia mori anën* (bisedës etj.) dikush - e kuptoi, hyri në temë. ❖ *ia mori anën* (punës etj.) dikush - e mësoi; ia mori dorën. ❖ *e mora me anë* dikë - e binda, ia mbusha mendjen,

8.1. Në Fjalor gjejmë shumë njësi frazeologjike të motivuara me emërtime **nga bota e kafshëve**, duke formuar një nga grupet më të mëdha të këtyre njësive. Kafsha, emërtimi i së cilës ka shërbyer si gjymtyrë kryesore motivuese për njësitë, mund të jetë e egër, por dhe e butë. Madje, me emërtimet për kafshët e buta janë krijuar më shumë njësi, sesa me emërtimet për ato të egrat. Një nga arsytet e kësaj dukurie është se njeriu (në rastin tonë, vetë devolliu) e njeh shumë nga afër kafshën e butë apo atë

⁷ Të gjitha njësitë frazeologjike, fjalët e urta, proverbat etj., në Fjalor jepen pas shenjës ❖.

shtëpiake, ia njeh cilësitë (të mira a po të këqija) apo dobishmërinë. Kjo ka mundësuar shndërrimet e figurshme të qindra e qindra sintagmave të lira me gjymtyrë kryesore emërtimin e këtyre kafshëve në njësi frazeologjike. Po japim për ilustrim njësi me fjalën *ari* dhe *gomar*:

arí,-u m. (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Shpella e Ariut*). ♦ *ra si ariu bë mjaltët* dikush - *shak.* nuk ka të ngopur; është shtruar për të ngrënë dhe nuk ka të sosur. ♦ *ariu fle, ti vete e zgjon* - ngacmon, cyt dikë pa marrë parasysh pasojat e këqija që do të kesh. ♦ *e luan si arinë* dikë - e rreh, e mundon shumë. ♦ *s'ngopet ariu me marauzhga!* - *iron.* thuhet për dikë që nuk ngopet me gjëra të lehta. ♦ *pinë arinjtë, pinë dhe minjtë* - *tall.* përdoret për dikë që dehet shpejt, pihet me një gotë raki. ♦ *ia var ariut zilen* dikush - është trim i madh, nuk merr parasysh asnjë rrezik. ♦ *e vranë arinë* - *iron.* iku ajo kohë, nuk është si më parë, nuk ka më të mira pa fund.

gomár,-i m. ♦ *gomari badjava s'shikohet nga dhëmbët* - *fj. u.* mos thuaj gjë kur të falin diçka. ♦ *sa bëhet gomari kalë, aq bëhet dhëndri djalë* - *fj. u.* ♦ *s'ka ç'i bën gomarit, bot samarit* - nuk di kujt t'ia nxjerrë inatin; merr hak ndaj atij që nuk ka faj. ♦ *nuk çalon gomari nga veshët* - *shak.* shprehja përdoret për dikë që ankohet për ndonjë gjë fare të vogël, pa rëndësi, që nuk prish punë. ♦ *çuksh gomarit, bot samarit* - njeri i grindur. ♦ *sa ç'ka gomarë jeshilë, aq ka dhe burra të mirë* - *fj. u.* ♦ *gomarit të botës i këputet palldëmi bë të përpjetë* - *fj. u.* ♦ *sa gomarë buzëbardhë* - sa gjëra të ngjashme ka, nuk është ajo që thua ti. ♦ *u gjet si gomari dë duhant* - thuhet për dikë që është qortuar a sharë padrejtësisht. ♦ *gomari që të hedh, hipe gjene (prapë)* - duhet të këmbëngulësh në një punë. ♦ *e hipi bë gomarin e Koles* dikë - e talli, e qesëndisi, e vuri në lojë. ♦ *të hip bë dyzet (bë njëqind) gomerë* dikush - të premton shumë. ♦ *e hip gomarin pa samar* dikush - vendos shpejt e pa u menduar për të bërë diçka. ♦ *si gomari dë pollogt* - *tall.* në mes të të mirave, duke patur gjëra që nuk i meriton. ♦ *sa gomari i hallos* - *shak.* shumë i vjetër në moshë. ♦ *e ha si gomari gjembin* dikush/diçka - e ha me shumë shije. ♦ *nuk hip dot gomarë e tij* dikush - është i pazoti. ♦ *i ka hipur gomarit së prapi* dikush - punon keq, ka nisur një rrugë që nuk do t'i dalë mirë, e ka nisur ters. ♦ *gomar me lecka* - *iron.* i veshur me shumë rroba e pa lezet. ♦ *s'di nga lidhet gomari* dikush - *tall.* s'merr vesh fare për një punë, nuk është i aftë të bëjë asgjë. ♦ *u lëshua si gomari dë lakrat* dikush - *keq.* ha me oreks të madh; nuk pushon së ngrëni. ♦ *le gomari që na ngordhi, po s'na lënë rehat as mizat* - thuhet për dikë që e ngacmon kur ai ka një hall. ♦ *gomar të ishte do kishte ngordhur* - thuhet për dikë që e rrahin shumë e nuk vë mend. ♦ *ç'më duhet ta shpoj gomarin të pjerdhë* - *thjeshtligj.* s'duhet të ngacmoj dikë që

të thotë ndonjë fjalë të ligë. ❖ *gomar e vënë (e ulin), gomar e ngrënë - keq.* e shajnë të gjithë ngaqë nuk është i zgjuar. ❖ *pse e ftojnë gomarin bë dasmë?! - iron.* thuhet për dikë që e marrin vetëm për punë të rënda. ❖ *gomar hipur, gomar kërkon -* është i hutuar. ❖ *kur të pëllasë gomari i zi -* kurrë, asnjëherë. ❖ *gomar plak me palldëm të kuq -* thuhet për një plak që bën veprime prej të riu, kur një plak vishet si i ri. ❖ *prit gomar të mbijë bar -* përdoret kur një punë zvarritet. ❖ *kur të pëllasë gomari bë çatit -* kurrë, asnjëherë. ❖ *sikur shpon gomarë -* shkel e shko, kot, keq. ❖ *e zë gomarin nga bishti dikush - iron.* nuk ia di radhën punës, është pa përvojë. ❖ *gomar me zile - keq.* budalla.

8.2. Gjithashtu, një grup të madh paradigmatic formojnë dhe njësitë frazeologjike të motivuara me emërtime *nga bota e bimëve*. Po japim për ilustrim:

kúngull,-i ❖ *u bë (u rrit) kungulli mori gardhin - iron.* i thuhet një njeriu të vogël në moshë, që kërkon të hiqet si i madh, ose që kërkon të hiqet më i mençur nga sa është. ❖ *u bë kungulli me vesë, mori vrimën e halesë - thjeshtligj.* është mendjemadh. ❖ *u bë si kungulli kur e zë bryma -* u dobësua shumë. ❖ *ra kungulli nga polica - iron.* u dëmtua diçka pa vlerë. ❖ *kungull ditë, kungull natë, kungull mos të mbiftë fara -* përdoret kur dikush është në gjendje të keqe ekonomike. ❖ *kungull pa fara - tall.* njeri pa mend në kokë; i paditur. ❖ *pjerdhin në një kungull - keq.* janë njëllë, bëjnë të njëjtën gjë, kanë qëllime të njëjta. ❖ *qesh kungulli lagjinë - tall* i qeshuri të qeshurin, tall i keqi të keqin. ❖ *kungull Stambolli -* që është bërë, që është arrirë. ❖ *të plastë kungulli! -* të plastë koka! ❖ *e shpoi kungulli fundin e kuisë -* thuhet për dikë që ka qenë i varfër gjithë jetën. ❖ *si lulja e kungullit dikush -* i frikësuar, i trembur.

8.3. Në Fjalor kanë zënë vend dhe njësi frazeologjike të motivuara me emërtime *nga bota e insekteve*: **mórr,-i m.** ❖ *u bë morri me bisht -* është shumë i ndotur; ka papastërti të madhe. ❖ *ia ra morri dë pjatët dikujt - keq.* u zbulua se kush ishte; i dolën të palarat në shesh. ❖ *s'ka morr të kruhet dikush - iron.* është shumë i varfër. ❖ *iu ngjallën morrat dikujt -* u përmirësua, u gjallërua dhe nuk rri rehat. ❖ *rri si morr i vrarë (i përvëluar) - keq.* ndjehet keq për fajin që ka bërë. ❖ *të qeth (të kreh) dhe t'i lë morrat brenda dikush - iron.* të lëvdon e nuk të thotë të vërtetën; është dinak.

8.4. Por grupin më të madh në Fjalor e krijojnë njësitë frazeologjike të motivuara me emërtime *për pjesë të trupit të njeriut*. Mjafton të japim vetëm një lagje të tillë njësishe, ata që motivohen me fjalën *bark*, për të parë numrin e madh të tyre.

bárk,-u m. ❖ *e bëri barkun hambar* dikush - tregohet zemërgjerë, e pranon tjetrin me të mirat dhe të këqijat e tij. ❖ *e bëri barkun çizme (spathi)* dikush - tall. hëngri shumë; i plasi barku së ngrëni. ❖ *iu bë barku petë* dikujt - nuk ka ngrënë prej kohësh ose nuk ka oreks për të ngrënë. ❖ *iu bë barku talambak* dikujt - hëngri shumë, iu fry barku nga sasia e madhe e ushqimit. ❖ *i ra barku bë bela - shaka.* hëngri e piu mirë; ka rënë në të gjithë të mirat. ❖ *mos të rëntë dë barkt!* - mallk. mos u ngopsh! ❖ *më s'të ra dë barkut - keq.* nuk ngopeshe kurrë së ngrëni. ❖ *e bluan dë barkut* diçka - e mban brenda shqetësimin. ❖ *s'ia çaj dot barkun* dikujt - nuk e di se ç'mendon. ❖ *çajne barqet* - zihen, grinden. ❖ *nuk i digjet barku* për dikë - keq. nuk e do, nuk e merr malli për të, s'pyet për të. ❖ *barku i fundit* - barra, fëmija i fundit. ❖ *me bark de goja* - thuhet për një grua që është me barrë, në prag të lindjes. ❖ *na hapi barkun* dikush - 1. tha gjëra të këqija që i kishim harruar. 2. të vjen pështirë kur e sheh në atë gjendje. ❖ *ma ike barkun* 1. më trembe shumë. 2. më fute krupën, me vjen shumë ndot. ❖ *të ik barkun* - është shumë i shëmtuar; nuk e shikon dot me sy. ❖ *një bark kam* - nuk ha dot më, u ngopa. ❖ *e ka barkun të djegur (të zhuritur)* dikush - 1. nuk ka (nuk bën dot) fëmijë. 2. i ka ndodhur ndonjë fatkeqësi e madhe me të afërmit. ❖ *e ka barkun hambar* dikush - është shumë i duruar. ❖ *e kam barkun bë një pe* - jam shumë i uritur. ❖ *të kesh dy barqe: një ta çash, një ta ndash* - i thuhet dikujt që mburret a thotë gjëra të paqena. ❖ *ka lëshuar bark (muri, tavani)* - është shtrembëruar nga pesha. ❖ *më mbiu dë barkt* diçka - kam ngrënë shumë herë të njëjtën gjë. ❖ *dë barkt mbajç, bë pëqit mos paç!* - mallk. lindsh dhe të vdektë fëmija. ❖ *i ndrittë barku që e ka mbajtur* - urim. thuhet për dikë që është shumë i mirë dhe zemërbardhë. ❖ *ia ngroh barkun* dikujt - i them një fjalë të mirë për t'i dhënë zemër. ❖ *përpiva barkun* - u tremba shumë. ❖ *i plasi barku* dikujt - duroi shumë, nuk foli fare. ❖ *të prish barkun - iron.* i thuhet dikujt që kërkon një gjë shumë të mirë për të ngrënë. ❖ *i rrahin barqet* dikujt - punon larg shtëpisë dhe në punëra të vështira. ❖ *më shtiri (më hapi) barkun* dikush a diçka - më erdhi shumë ndot; më tromaksi; më fute krupën. ❖ *barku mban një thes me mut, ti nuk mban dot një llaf - thjeshtligj.* thuhet për dikë që nuk mban asnjë të fshehtë, që sapo dëgjon një gjë do që t'ua thotë të tjerëve. ❖ *që dë barkun e nënës* - që në origjinë, qysh në fillim. ❖ *është i trembur që dë barkun e nënës* dikush - është njeri frikacak në jetë.

8.5. Në veprën *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit* kanë zënë vend një numër shumë i madh njësisht frazeologjike me ngjyrim të theksuar emocionues. Është e kuptueshme që si vatër motivuese e këtyre njësisve (që ndeshem orë e çast në ligjërimin e përditshëm e, sidomos, në ligjërimin e

thjeshtë, madje ky ligjërim është i zbërdhulët pa këto lloj njësisë) janë emërtime që në strukturën e tyre kuptimore semat themelore referojnë përbërës me ngjyrim të theksuar emocionues negativ. Një pjesë e madhe e këtyre njësive mbeten në kuadrin e këtij ligjërimi, edhe pse bëjnë pjesë në pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes. Po ilustruam:

býth/ë,-a f. ❖ *u bë bythë* dikush - *thjeshtligj.* u deh, u bë tapë. ❖ *e bëri për dë bythë të qenit* dikë - *thjeshtligj.* e shau rëndë, nuk i la gjë pa thënë. ❖ *s'i ka rënë bytha dë ujët* dikujt - *thjeshtligj.* nuk ka parë vështirësi, nuk ka hequr keq asnjëherë. ❖ *bjeri bythës me kacit!* - *thjeshtligj.* s'ke ç'bën më, nuk ke nga ia mban. ❖ *janë bythë e bardhakrrinë* afër e afër, janë të lidhur ngushtë. ❖ *janë bythë e brekë* - *keq.* të lidhur ngushtë me njëri - tjetrin. ❖ *bythë bë bythë* - pranë e pranë. ❖ *na çau bythën!* dikush - *thjeshtligj.* na mërziti. ❖ *i di bytha* dikujt - *thjeshtligj.* është i zgjuar; mendon si të përfitojë sa më shumë për vete. ❖ *di bythën e shejtanit* dikush - *përbuz.* merr vesh nga të gjitha gjërat; është shumë i futur. ❖ *s'i ka dërsirë bytha* - s'është lodhur; nuk ka bërë punë të vështira. ❖ *s'i ka djegur bytha* dikujt - *thjeshtligj.* nuk e ka pësuar ndonjëherë; s'ka paguar vetë. ❖ *bytha e dynjasë* - shërbëtor i të tjerëve. ❖ *i dredh bythët* dikush - nuk e mban fjalën e dhënë. ❖ *nuk dhitet me bythën e botës* - *thjeshtligj.* thuhet për dikë që një gjë të vështirë nuk e zgjidh vetë, por do që ta bëjnë të tjerët. ❖ *iu fëc bytha* dikujt - u lodh shumë, nuk ka më fuqi të punojë. ❖ *bythë të forta!* - *iron.* ia dalç mbanë! ❖ *ia fryu bythën* - e ushqeu shumë mirë; e shpërbleu shumë. ❖ *fshije bythën me qeramidhkë* - *thjeshtligj.* nuk ke për të marrë gjë tjetër; i more ato që të takonin. ❖ *u ftofsh dë bythët* - *tallës.* përdoret për dikë që thotë gjepura; që flet gjëra të paqena. ❖ *gris bythën* - *thjeshtligj.* ik, zhduku; thyej qafën. ❖ *s'gjen një bythë vënt* - nuk ke ku të ulesh; ka shumë njerëz. ❖ *e ka bythën të madhe* dikush - *keq.* mendon vetëm për vete. ❖ *e ka bythën me majë* dikush - nuk rri në një vend, është shumë i lëvizshëm. ❖ *s'ka bythë të rrijë* - thuhet për diçka që nuk qëndron, që s'është e vërtetë a e drejtë. ❖ *s'ka më bythë viçi* - nuk është më si më parë. ❖ *i bardhë si bytha e kuisë* - *iron.* e zezë, e papastër. ❖ *mos e kruaj bythën!* - *thjeshtligj.* mos u tall, mos më ngacmo. ❖ *i kruhet bytha* dikujt - nuk rri rehat, i ngacmon të tjerët. ❖ *e lan bythën pa ujë* dikush - nuk i thotë gjërat siç janë; u kalon anash shumë gjërave shqetësuese. ❖ *iu lodh bytha* dikujt - *keq.* nuk është më i zoti për të bërë një punë të vështirë. ❖ *bythën e mbuluar s'e pështyn njeri* - *fj. u. thjeshtligj.* ❖ *s'ia mban bytha* dikujt - nuk është më i zoti për të bërë një punë që kërkon shumë mund. ❖ *s'i pjerdh bytha* dikujt - *përbuz.* 1. nuk interesohet, nuk bëhet merak. 2. nuk e përfill, nuk ka frikë nga dikush. ❖

bythë e plasur (nga Kolonja) - përdoret kur nënvleftësojmë dikë a diçka. ❖ *i plasi bytha* dikujt - *thjeshtligj.* nuk kujdeset fare për dikë a diçka, nuk i intereson ❖ *ia pret bytha penë* - iron. është shumë i zgjuar. ❖ *më rrahu bythën* - më talli, më përçmoi. ❖ *s'i rri bytha bë një vënt* dikujt - është shumë i lëvizur. ❖ *sheh bythën e tij* dikush - mendon vetëm për vete. ❖ *i shkon pas bythës* dikujt - ia bën qejfin. ❖ *do të ta shoh bythën* - i thuhet dikujt që mburret për një punë. ❖ *s'e shtron bythën* dikush - nuk punon. ❖ *si bytha e tiganit* - i pistë, i zi. ❖ *tund bythët* dikush - *thjeshtligj.* është dembel. ❖ *i vajti bytha dë hendekt* - nuk ka më fuqi, u plak. ❖ *e vuri bë bythë* dikë - *thjeshtligj.* e munda, e mposhti. ❖ *zë një bythë vënt* dikush - është i vogël nga trupi. ❖ *nuk i zë bytha vënt* dikujt - është shumë i lëvizur, bythëlëvizur. ❖ *i zuri bytha kallo* - ndenji shumë ulur në një vend.

mút,-i m. ❖ *ia bëj mutin* dikujt a diçkaje-*thjeshtligj.* e lë, nuk e përfundoj. ❖ *nuk bëhet muti kthis-keq.* jo çdo lëndë mund të përdoret për ndërtim. ❖ *u bë muti i maces për ilaç-thjeshtligj.* nuk mund të marrë vlerë diçka fare e parëndësishme. ❖ *i bie mutit me lugë* dikush- *keq.* s'është më i zoti; nuk e nxjerr qimen nga qulli. ❖ *është bërë si muti i ariut*-është në gjendje të keqe. ❖ *ha mut për hatër* dikush- *tall.* futet kot në një ngatërresë; mban anën e dikujt edhe kur dëmtohet vetë. ❖ *muti i halesë-shar.* njeri i keq, pa karakter. ❖ *e hëngri atë mut*-pranoi diçka që i solli dëm. ❖ *s'lahet (s'mbulohet) muti me shurrë*-nuk mund të fshihet diçka e keqe. ❖ *të marrtë muti shalët!*-mallk. e pësofsh! ❖ *muti mut mbetet-thjeshtligj.* njeriu i keq nuk mund të ndryshojë në karakter. ❖ *si mut i ngrirë*- *thjeshtligj.* pa personalitet, pa dinjitet. ❖ *iu ngjit si muti pas këpucës* dikujt-nuk i ndahet, e bezdis vazhdimisht.

bálg/ë,-a f. 1. bajgë. 2. *keq.* njeri pa nder e personalitet. ❖ *ia bëri balgën* diçkaje a dikujt - iku, e braktisi. ❖ *po i bie erë balgës* dikush - *shaka.* u rrit, u poq seksualisht. ❖ *s'i digjen balgat* dikujt për dikë - *keq.* nuk e do, nuk e merr malli; nuk do t'ia dijë për dikë. ❖ *flet atje ku i digjen balgat* dikush - shkon, rri a flet ku i pëlqen, ku e presin më mirë, është interesaxhi. ❖ *e holloi balgën* dikush - *keq.* u sëmur keq, është në prag të vdekjes. ❖ *ia la balgat* dikujt - iku, e braktisi. ❖ *si balgë e ndarë bë dysh* - *thjeshtligj.* shumë e shëmtuar, që nuk merret vesh se ç'është. ❖ *ia ngriu balgat* dikujt - e trembi, ia mblodhi keq me ato që i tha. ❖ *e ntrashi balgën* dikush - *tall.* filloi të dalë nga gjendja e keqe; u përmirësua.

9. Emërtime të pathjeshta

Duke u ndalur në përbërësit e makrostrukturës së *Fjalorit leksiko-frazeologjik të Devollit*, theksojmë se një vend të posaçëm në të kanë zënë dhe shumë emërtime të pathjeshta, që lidhen së shumti me botën bimore e

atë shtazore. Po japim për ilustrim një grup paradigmatic njësish me gjymtyrë kryesore fjalën *lule*:

lúl/e,-ja: *lule akulli, lule akshami, lule bako, lule balsami, lule begonjë, lule bore, lule borziloku, lule deleje, lule dredhkë, lule fasule, lule gramafonkë, lule grerë, lule gjarpri, lule gjuhëvjehrrë, lule jargavani, lule karafili, lule kineze, lule livanto, lule manushaqe, lule mëllagë, lule patate, lule poleska, lule mos më prek, lule paraçkë, lule shelgu, lule shëmitri, lule shpatë, lule shqiponjë, lule top dëbore, lule uji, lule veshgomari, lule vëthkë* etj.

10. Relacionet leksiko - semantike

Fjalori shpërfaq një tjetër vlerë të rëndësishme. Autori ka synuar të japë në sistem edhe elementet që ndërtojnë mikrostrukturën e fjalës. Një nga këto elemente është dhe paraqitja, atje ku është e mundshme, e relacioneve kryesore leksiko-semantike.

10.1. Polisemia është një nga relacionet më të hasura në pasurinë që ka zënë vend në këtë vepër. Ajo haset jo vetëm tek fjalët, por dhe te njësitë frazeologjike. Po japim disa shembuj:

balásh,-i m. 1. ka me pullë në ballë. 2. shpend uji me pupla të zeza e të bardha, që ushqehet me peshk. 3. *mb.* që ka pullë të bardhë në ballë: *Prapa asaj korije / ljepuri ndën hije / ljepuri murrash-e / dë ballët balash-e.* (K. Zdruli, FDS). ❖ *ka balashi dhjamë* - thuhet me shaka për dikë që të tjerët e dinë të pasur, por në të vërtetë nuk është ashtu. ❖ *e përqesh balashi* - i duket sikur e tallin të tjerët.

kërcú,-ri m. 1. cung druri: *Atje nga kërcuri del një gjarpër i zi.* (K. Zdruli, FDS). 2. *fig.* fjalë e rëndë: *Barba e shpuri buzën për të qeshur, i vendosur t'i këpuste ca kërcunj të birit në sy të profesorit.* (H. Lilo, O). 3. *mb. fig.* njeri pa njeri, i vetmuar, i shkretë: *Moj më shuaqti burri / Moj nëno/Më la vetëm si kërcuri.* (Koçillari, TShD). 4. *mb. fig.* i paditur, që nuk ka shkollë, i paarsimuar: *Unë spara ua thoshja mësimeve, po Tana ishte kërcu fare.* (Th. Jorgji, PD). ❖ *është kërcu nga mendja dikush - keq.* nuk ka fare intelekt; është i trashë. ❖ *i këputi (i lëshoi) ca kërcunj* diku - i tha fjalë shumë të rënda; e lëndoi shumë. ❖ *e la kërcu dikë* - mbeti pa njeri, nuk ka kush kujdeset më për të. ❖ *mbeti kërcu dikush* - nuk bëri shkollë.

Siç thamë, polisemia shfaqet edhe te njësitë frazeologjike: ❖ *na hapi barkun* dikush - 1. tha gjëra të këqija që i kishim harruar. 2. të vjen pështirë kur e sheh në atë gjendje. ❖ *ma ike barkun* 1. më trembe shumë. 2. më fute krupën, me vjen shumë ndot. ❖ *të ik barkun* - është shumë i shëmtuar; nuk e shikon dot me sy. ❖ *e ka barkun të djegur (të zhuritur)* dikush - 1.

nuk ka (nuk bën dot) fëmijë. 2. i ka ndodhur ndonjë fatkeqësi e madhe me të afërmit.

10.2. Sinonimia është relacioni më i njohur në Fjalor dhe që është përdorur nga autori me frytshmëri, sidomos për të shpjeguar njësi që janë pak të njohura për përdoruesin e shqipes ose që nuk njihen aspak prej tij. Autori ka meritën se në marrëdhënien sinonimike i ka dhënë përparësi fjalës shqipe, që i përket leksikut normativ të shqipes standarde. Meqenëse sinonimia është e gjerë, po japim disa grupe që lidhen së shumti me përkatësinë leksiko-gramatikore të njësive që hyjnë në këto lloj marrëdhëniesh:

10.2.1. Sinonimi emërore: butúr,-i m. pluhur: *E ka nusen të mirë/ Kur na fshin' oborrë/ tërë buturë bë kokë.* (Koçillari, TShD); *Domethënë paskërkam qenë një...që i kam baritur buturit kot, tërë këto vite.* (A. Andoni, GML).

çobánk/ë,-a II f. 1. keq. vllahe, arumune. 2. bareshë: *Po shoqet ku i ke?/ dë mal të Gramozit-e/ ku rrinin çobanët-e/ ku rrinin çobankat-e.* (Koçillari, TShD).

10.2.2. Sinonimi mbiemërore: bythëvérdhë mb. i dobët: - *Cilët janë bythëverdhë? –pyeti Magelani.* - *Të përkëdhelurit, Magelan. Ata që nuk i ka zënë as era, as shiu, por që kanë punuar nëpër zyra.* ((Th. Naqo, PI).).

çaplúar (i, e) mb. 1. i çapëluar, i shqyer: *Tej pragut dukeshin shtëpi të djegura, plepa të çapluar dhe fytyrat e njerëzve të trembura.* (S. Andoni, MSh). 2. i hapur jashtë mase, i çuditur: *Kurbatka dilte nëpër derën e mullirit e ndjekur nga sytë e çapluar të Doracit që mërmëriste.* (A. Andoni, N).

njómtë (i, e) mb. i njomë: - *Këtë ftoin e ka mbjellë dedo Nasi. Ishte sa një deçkë kur e sollti. Fundin ia kishte mbështjellë me baltë të njomtë, që të mos thahej dhe e mbolli.* (Th. Jorgji, PD).

10.2.3. Sinonimi foljore: shastís fol. hutoj, habit, mrekulloj: *Na shkon dhëndri me bajrakë / moj, malet u hapnë ! / Le të hapen a t'vithisen / me djalit ton' do shastisen!* (K. Zdruli, FDS); *O, ky kapedani / Shastisi dynjanë.* (Koçillari, TShD).

përcíllet fol. rrjedh, del vetiu: *Tek-tuk dëgjohej ndonjë lopë që pëlliste për të kërkuar viçin se po i përcilleshin gjirët.* (H. Lilo, O). ♦ *se mos t'u përcollën gjirët!-shak.* i thuhet dikujt që ngutet, që kërkon të ikë sa më parë nga diku.

10.2.4. Sinonimi ndajfoljore: vícë ndajf. plot: *e mbushi vicë fuçinë.*

víckë ndajf. plot, vicë: *Dasmë bëri ky Rapushka / vickë shtëpinë me krushka/ ç'e tunde nja dhjetë ditë/ ngope sojnë, ngope miqtë.* (KPRrK).

10.3. Antonimia është një relacion tjetër leksiko-semantik që ka zënë vend në Fjalorin leksiko-frazeologjik të Devollit. Autori e ka përdorur atë si mjet të domosdoshëm për saktësimin e kuptimit të njësive si fjalë titull.

allafrënga ndajf. në mënyrë franceze (qytetare, perëndimore); kund. allaturka: *Pantallonat dhe jelekun allafrënga Xhakua i mori borxh te dyqani.* (A. Andoni, N).

jagallëk,-u m. mot me lagështirë; kund. **kurakllëk**: *Në këtë jagallëk erdhe të qajmë për trimin?* (S. Andoni, ShShN).

(h)alláll,-i m. 1. diçka e lejueshme dhe e drejtë; diçka e fituar me meritë; kund. haram: *Këta djem që janë sot / hallall ju qoftë dashuria.* (Koçillari, TShD). 2. njeri i mirë dhe i drejtë. ❖ *ma bëj hallall* - më fal. ❖ *hallalli s'bëhet harram* - fj.u. ajo që fitohet me punë nuk humbet kurrë. ❖ *e ka hallall* dikush /diçka - e meriton.

10.4. Homonimia është një tjetër relacion leksikor i rëndësishëm në Fjalor. Aty gjejmë 96 çifte homonimike, që, përsëri, sendërton punën e kujdeshme vjelëse dhe hartuese të autorit të veprës:

álk/ë,-a_I f. ajkë, kajmak. ❖ *ia mori alkën* diçkaje - ia mori pjesën më të mirë. ❖ *e ka rritur me alkën e qumështit* dikë - e ka ushqyer me gjithë të mirat.

álk/ë,-a_{II} f. gozhdë e vogël për të mbërthyer këpucët etj.

arúshk/ë,-a_I f. 1. këlyshka, e vogla e arushës (edhe si emërvend: *Arushka e Ndreçit*). 2. kukull me pamjen e arushkës. 3. *fig. përkdh.* fëmijë i shëndetshëm: *arushka e nënës!*

arúshk/ë,-a_{II} f. etnog. lloj bukuvaleje që bëhet për Vitin e Ri: *Mbrëmjen e Vitit të Ri gatuajnë një lloj bukuvaleje me miell të grunjte, të pjekur në tepsitë dhe të dërrmuar pastaj, të cilën e quajnë arushkë dhe para se ta shtrojnë për ta ngrënë në darkë e lënë një hop prapa portës së jashtme të shtëpisë "që ta hajë arushka".* (V. Xhaçka).

ashík,-u_I m. 1. është e vogël në gjurin e përparmë të bagëtive të imëta; kyçi i këmbës; 2. lloj loje që bënin fëmijët në fshat me ashikët: *Ndëne jastëk dukej maja e cinglës dhe një ashik i rënduar me plumb.* (S. Andoni, KSh).

ashík,-u_{II} m. i dashuri (edhe si patronim, llagap): *Po jam prerë dru pe fiku/ që t'englendisët ashiku!* (K. Zdruli, FDS).

(h)umbëtír/ë,-a_I f. vend që ka humbë. **[(h)úmb/ë,-a_I** f. baltë argjile që përdorej për të larë flokët (edhe si emërvend: *Humbë; Humbat*).]

(h)umbëtír/ë,-a f. thellësirë, vend i shkretë: - *Hy, të plastë kungulli. Nga vjen ti, nga humbëtirat, - tha kapteri.* (T. Laço, M).

11. Shpjegimet kuptimore

Një fjalor shpjegues, aq më tepër një fjalor shpjegues dialektor, vlerësohet për shpjegimet kuptimore, për dhënien sa më të plotë dhe sa më të qartë të konceptit që na çon te realia, kuptimi i së cilës shpjegohet. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit* është një veprat më të arrira në këtë drejtim. Në faqet e tij ndeshim gati të gjitha llojet e shpjegimeve kuptimore, me mbizotërim të shpjegimeve me sinonimi dhe perifrazim.

11.1. Shpjegime me perifrazim:

bósh-t,-i m. shkop i shkurtër për të tjerë dhe mbështjellë fijen e leshit; drugë: *Tori capja dy boshtin/ dhe i vuri bë policë.* (Koçillari, TShD); - *Marsi, vërci, përci/ shqerkat, capkat i nxora/ boshtin shtëllung' e tora!* (K. Zdruli, FDS). ❖ *tjerr me një bosht dikush* - bën të njëjtën gjë.

balásh,-i m. 1. ka me pullë në ballë. 2. shpend uji me pupla të zeza e të bardha, që ushqehet me peshk. 3. mb. që ka pullë të bardhë në ballë: *Prapa asaj korije/ ljepuri ndën hije/ ljepuri murrash - e/ dë ballët balash - e.* (K. Zdruli, FDS). ❖ *ka balashi dhjamë* - thuhet me shaka për dikë që të tjerët e dinë të pasur, por në të vërtetë nuk është ashtu. ❖ *e përqesh balashi* - i duket sikur e tallin të tjerët

11.2. Shpjegimi me sinonimi:

bóstán,-i m. shalqi, pjepër: *Tek shkoja arave m'u kujtua bostani i mulla Elmazit.* (D. Agolli, ZhED). ❖ *ta ngresh dë bostant, ha gogoçët dikush* - iron. është veshur shumë keq dhe pa shije. ❖ *pret bostan e ha pjepër dikush* - tall. është hutaq i madh, i bën gjërat tjetër për tjetër.

11.3. Shpjegime me përshkrim:

gushëkúq,-i m. zog i vogël me trup të murrme e me gushë të kuqërreme: *Në fole prej bari rrojnë si fqinjë të mirë harabela e gushëkuqë, garguj e piktha.* (S. Andoni, MSh).

11.4. Shpjegim i ndërthurur: perifrazim / përshkrim dhe sinonimi: **bósh-t/ë,-a** f. *etnog.* lloj rrobeje e qëndisur me të cilën mbështillen e dërgohen rrobat e nuses ose të dhëndrit; deng, shami, mbështjellëse.

11.5. Kur njësitë leksikore (fjalët si zëra leksikografikë) janë të njohura, autori nuk ndalet në shpjegime kuptimore të panevojshme. Në këto raste, si jemi shprehur, strukturën kuptimore të zërit leksikografik, e formojnë zakonisht njësitë frazeologjike apo emërvendet.

këmb/ë,-a f. ❖ *bëri këmbë diçka* - 1. u përkëmb, u përmirësua. 2. e vodhën, e morën, e kanë zhdukur. ❖ *më bëri këmbë dikush* - *etnogr.* hyri i pari në shtëpi në një ditë të shënuar. ❖ *nuk i bëjnë këmbët dikujt* - 1. nuk

ka fuqi për të bërë një punë. 2. nuk ka guxim e dëshirë; nuk i bën zemra. ❖ *i bëri këmbët bigë* dikush - keq. vdiq. ❖ *ia bëri këmbët bigë* dikujt - ia mbledhi, nuk e la të bënte si të donte. ❖ *ia bëj këmbët çift* dikujt - ia mbledh duke e kritikuar, duke i kërkuar llogari; ia fut këmbët në një këpucë. ❖ *i bën këmba e dora* dikujt - ka ende fuqi, nuk e ka mposhtur pleqëria, mbahet. ❖ *u bëmë si këmbët e dhisë* - jemi njëlloj; nuk kemi asnjë ndryshim. ❖ *e bëri këmbën kobure* dikush - keq. vdiq, na e mori të keqen (për dikë që e kemi urryer). ❖ *këmbës t'i biesh* - i thuhet dikujt kur nuk duam t'ia plotësojmë një kërkesë të tepërt, një tekë (zakonisht fëmijëve). ❖ *më ranë këmbët (copë)* - e kërkoja gjithandej; s'lashë vend pa kërkuar. ❖ *i rënç këmbës!* - mallk. vdeksh! ❖ *u çaplua nga këmbët* - vrapoi shumë për ta arritur dikë, u rraskapit. ❖ *e drodhi këmbën* dikush - keq. vdiq, ngordhi. ❖ *i dridhen këmbët* dikujt - ka shumë frikë nga dikush; është shumë i emocionuar. ❖ *fle bë këmbë* dikush - mospërf. është i fjetur dhe i humbur. ❖ *ia fut këmbët bë një këpucë* dikujt - ia mbledh, nuk e lë të bëjë si të dojë. ❖ *ia futi (ia vuri) këmbët bë rript të dyfekut* dikujt - ia mbledh, nuk e lë të bëjë si të dojë. ❖ *nuk i gjenden këmbët gjarpërit* - thuhet për dikë që di t'i fshehë ato që bën. ❖ *më hanë këmbët* - dua të shkoj sa më parë diku; nuk më rrihet. ❖ *me sa i hanin këmbët* - duke vrapuar me të gjitha fuqitë. ❖ *s'të hahen këmbët* - i thuhet dikujt që përtan të shkojë diku për të kryer një porosi; nuk duhet të kursehesh për të bërë një gjë që të urdhëron dikush. ❖ *sa herë ta hedhësh bie bë këmbë* dikush - është shumë i zoti; nuk ke se ç't'i bësh. ❖ *po heq këmbën* dikush - është duke vdekur. ❖ *e heq këmbën branë* dikush - iron. është dembel, nuk bën asnjë punë. ❖ *hëngri këmbët e tij* dikush - nuk ka asgjë për të ngrënë, ka mbetur pa gjë; vuan shumë. ❖ *është i këmbës* dikush - ecën shpejt, nuk ia kalon dot në të ecur më këmbë. ❖ *jepu këmbëve!* - ec më shpejt; nxito. ❖ *i ka këmbët të lidhura* dikush - nuk lëviz dot se ka fëmijë të vogël ose dikë të sëmurë në shtëpi. ❖ *e ka këmbën bë yzengjit* dikush - është i gatshëm për të shkuar kudo që e dërgojnë. ❖ *t'ia lash këmbët e t'i pish ujët* - duhet t'i jesh shumë mirënjohës dikujt për nderin që të ka bërë; meriton nderimin më të madh. ❖ *e lanë këmbët* dikë - u plak, s'ka më fuqi. ❖ *del për të lëshuar këmbët* dikush - punon sa për t'u argëtuar; nuk e detyron kush që të punojë shumë. ❖ *të lumshin këmbët!* - urim. për dikë që vjen në shtëpi. ❖ *i mban këmbët bë hit* dikush - përtan shumë, nuk punon, është dembel. ❖ *me këmbë të mbarë!* - urim. ❖ *i mprehu këmbët* dikush - u bë gati për të nxituar. ❖ *e ngriti këmbën si breshka* dikush - keq. e pësoi keq nga veprimi që bëri, mori atë që meritonte. ❖ *ka nxjerrë këmbët më parë* dikush - keq. është shumë i prapë. ❖ *ia puth këmbët* dikujt - keq. i lutem

shumë, i përulem. ❖ *qafsh këmbët!* - *mallk.vdeksh!* ❖ *i është qepur këmba* - *këmbës* dikujt - nuk i ndahet, nuk i shqitet, e kontrollon vazhdimisht. ❖ *të rrahësh këmbën e kalit* - është diçka e rrallë, nuk e gjen lehtë edhe po ta kërkos. ❖ *rri me këmbë dë kllanik* dikush - nuk bën asnjë punë, është dembel. ❖ *shkruan me këmbët e pulës* dikush - *keq.* ka shkrim shumë të çrregullt; nuk di të shkruajë mirë. ❖ *e shpie këmbën për gjemb* dikush - *keq.* kërkon sherr; bën një veprim a thotë diçka për të shkaktuar grindje; është grindavec. ❖ *shpjeri këmbët siç bie daullja* - bëj siç bëjnë të tjerët. ❖ *më shtiri këmbët* dikush - e kërkova gjithandej; mezi e gjeta a e arrita. ❖ *tund këmbët bë diellit* dikush - *keq.* rri kot; nuk bën asnjë punë. ❖ *ua therri këmbëve* dikush - iku me vrap i tmerruar. ❖ *theu këmbën e shejtanit* dikush - thuhet për dikë që nuk kishte ardhur prej kohësh. ❖ *theftë këmbën!* - *mallk.* mos ardh! ❖ *t'i theva këmbët!* - mos vepro ashtu. ❖ *i thirri këmbës* dikush - iku me të shpejtë, u zhduk, nuk u pa nga vajti. ❖ *këmba e urës* - *shak.* i prapë, shumë i zgjuar. ❖ *të urgus nga këmbët* dikush - të mërzit me fjalë; është llafazan. ❖ *erdhi bë këmbë të tet* dikush - thuhet kur djali shkon diku në vend të të atit. ❖ *ku vë këmbët, vë kokën* - ka shumë dhembje, nuk duron dot. ❖ *ku vë këmbët të rënçin dhëmbët* - *fj.u.* ❖ *s'i zënë këmbët dhë* - ka shumë punë; bën disa punë njëherësh. ❖ *i zuri këmba shesh* - gjeti rehat, ra në qetësi.

12. Jeta e fjalës sintagmatike

Një nga vlerat e merituar të veprës *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit* është plotëria e shembujve që ilustrojnë jetën e fjalës, të kuptimeve të saj si dhe të njësive frazeologjike, por shpesh edhe të njësive të tjera që lidhen me elemente të etnokulturës, të onomastikës, toponomastikës etj. Po japim një shembull se si te një fjalë shumëkuptimëshe jepen shembujt të ndryshëm, e tepër funksionalë. Ilustrimet mund të jenë nxjerrë nga letërsia artistike, nga letërsia gojore (folklori), nga letërsia shkencore, pedagogjike, nga vjeljet në bisedat e synuara apo ato të rastit.

klëçk/ë,-a f. 1. copë e vogël druri ose degë e hollë dhe e gjatë: *Na veroren shçere në kleçkë/ Bë drekë bukë me veçkë.* (Koçillari, TShD); *Mësuesi theu një kleçkë të thatë që mbante në dorë.* (D. Agolli, KM) 2. *fig.* pengesë, e metë, diçka jo e mirë: *Burrrat në kafene nuk po e ndanin dot nëse kjo ishte vërtet për mirë apo kishte ndonjë kleçkë.* (T. Laço, M); *Ai i ka gjetur gruas një kleçkë në biografi dhe kërkon ta ndajë.* (D. Agolli, TG). 3. *fig. keq.* diçka shumë e hollë dhe e dobët: *Në jelek të mbahem mend / Të harrosh pak burrin tënd/ këmbën kleçkë e syrin gjëmb.* (D. Agolli, ShGj). ❖ *e ka bërë me kleçka diçka* - e ka sajuar shpejt e shpejt;

nuk e ka bërë mirë një gjë. ❖ *ia gjeti (i nxori) kleçkën* dikujt - i zbuloi një gjë të fshehtë a i sajoi diçka të dyshimtë për ta mposhtur, për ta mundur. ❖ *i nxjerr kleçka* dikujt - e pengon për të bërë diçka. ❖ *kleçkë e katranit* - shumë i fortë.

12.1. Ilustrime nga letërsia artistike

çifteli,-a f. 1. kurorë flokësh në ballë: *Ajo kishte parë çiftelitë në kokën e tij dhe kishte klithur me tallje: - Iii, dukesh sikur e ke kokën të mbushur me kërmij!* (Th. Naqo, PI.). 2. ai që ka kurorë flokësh në ballë: *Nëna i kishte thënë: Çiftelitë martohen me nuskëz të urtë e të bukur që të mbush shtëpinë me kalamaj.* (Th. Naqo, PI).

12.2. Ilustrime nga letërsia gojore popullore (folklori): çisht *pasth.* përdoret kur përzëmë macen që të mos hajë diçka: *Lakrori me lakëra/ ç'e lashë në vatëra/ vajt' ma nisi maceja! çisht, çisht, moj e shkretë/ se më le vjerrën pa drekë!* (K. Zdruli, FDS).

12.2.1. Ilustrime nga folklori me këngë: korbë! *pasth.* i thuhet një gruajë të shkretë, të mjerë: *Fustanenë korbë që të djalërisë / dridhe, Malo, dridhe, kazan' e Ohrisë.* (KPRrK).

(h)up f. humb, nuk e kam më: *Ce kanë florinë / ce kanë paranë/ ma hupnë të rinë/ ma hupnë sevdanë/ mbeta un' e mjera me kokë mënjane!* (Koçillari, TShD).

12.2.2. Ilustrime nga folklori me gjëza

kaçamák,-u m. 1. mëmëligë, mëmëliqe: - *Ç'janë dy djem nga Piluri/ venë e vinë dë mulli/ të na bluajnë mjell të ri/ të na bëjnë revani/ revani e kaçamak/ ujë shumë e gjalpë pak.* (Koçillari, TShD).

lärë (i, e) mb. i lyer, i ngjyer me diçka: *Tre kandilka të argjenta/ katër jasht' e katër brenda/ tri të lara me flori.* (Koçillari, TShD). ❖ *i bën të lara dëpër ara - shpif, trillon, flet si t'i vijë për mbarë.*

Shumë shpesh, përmes sintagmatikës së njësive që janë pasqyruar në fjalor, ndeshemi me një pasuri njësish leksikore që dalin si enumeracione, por dhe një pjesë prej tyre edhe si sinonime.

xhúngo mb. 1. gungaç: *Merrte me radhë nofkat e shumë bashkëfshatarëve të mi: xhungo, syçakërr, hosten, balash, bythëverdhë, teleshmen, harrun, zuzar, cingun, trahanik, dem, ballëgjjerë, teknefes, përç, prapësirë, gjizanik, lërezëre, dënglaman e të tjera e të tjera si këto.* (Th. Naqo, PI). 2. i trashë nga mendja.

13. Toponomastika dhe onomastika

Siç jemi shprehur që në krye të këtij punimi paraqitës, në *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit* gjejmë një numër shumë të madh emërvendesh (toponime), si dhe emrat e banorëve sipas këtyre

emërvendeve (kur këto janë vendbanime, zakonisht si njësi administrative fshat, qytet, krahinë) duke e bërë toponiminë e krahinës së Devollit dhe emrat e banorëve sipas tyre një hapësirë ku mund të ndiqen e të kërkojnë informacione të larmishme: historike, etno-kulturore, gjuhësore, psikologjike, fetare etj. Në vijim po ndalemi pak më gjerë. Toponomastika, teknikisht ka zënë vend në disa forma:

13.1. Në Fjalor gjejmë emërvende si dhe emra të banorëve sipas fshatit, qytetit krahinës etj. si zëra të mëvetësishëm leksikografikë.

Grác/ë,-a f. fshat në perëndim të Devollit, rrëzë malit të Moravës.

gracár,-i m. ai që jeton a e ka prejardhjen nga fshati Gracë.

gracárk/ë,-a f. ajo që jeton a e ka prejardhjen nga fshati Gracë.

Vërlen,-i m. fshat në perëndim të Devollit, rrëzë malit të Moravës.

vërlenár,-i m. ai që banon a e ka prejardhjen nga fshati Vërlen i Devollit: *Poçar' vërlenarët / korrin gjyresarët.* (K. Zdruli, FDS).

vërlenárk/ë,-a f. ajo që banon a e ka prejardhjen nga fshati Vërlen i Devollit: *Kapshticarka, kufitarka/ ziçishtarka, me litarka/ vërlenarka, moj poçarka.* (K. Zdruli, FDS).

13.2. Toponimet janë parë si një ndër elementet e mikrostrukturës së një fjale, si në rastet kur kjo strukturë ka edhe shpjegimin kuptimor, edhe frazeologjinë, edhe një numër emërvendesh.

ÁR/Ë,-A f. tokë e punuar për t'u mbjellë (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Arat e Bardha; Ara e Brajës, Ara de Lisi; Ara e Abift; Ara e Bames; Ara e Boriqit; Ara e Brajes; Arat e Dardhave; Ara e Demkës; Ara e Dhimës; Ara e Fëllëzave; Ara e Frosës; Ara e Ganiut; Ara e Gërdes; Ara e Gjatë; Ara e Gjembit; Ara e Halitit; Ara e Hekuranit; Ara e Hoxhës; Ara e Hysniut; Arat e Izvorit; Ara e Kallojerit; Ara e Karanxhasë; Ara e Kastës; Ara e Kaunit; Arat e Keqe; Arat e Klishës; Ara e Koçes; Ara e Kondos; Ara e Kostës; Ara e Kuçarit; Arat Lart, Ara e Lazit; Ara e Madhe; Arat Maleçka; Ara e Memutkës; Arat e Merasë; Arat e Mullirit; Arat e Pellgos, Arat e Përes; Ara Përtej; Arat e Pitos; Ara e Priftit; Ara e Qenamit; Arat e Qereçit; Ara e Sadikut; Ara e Salishaqit; Arat Sokolina; Ara e Sulejmanit; Ara e Shabanicës; Ara e Shefqetit; Ara e Shytit; Arat e Vakëfit; Arat e xha Jasharit; Ara e Xhelkës; Ara e Zaçkës; Ara e Zeqos; Arat e Zeza; Ara e Zitos; Arat e Zhupanit; etj.) ❖ *ara e mban farën - fj. u. gjatë punës mund të shkojë dëm diçka e vogël. ❖ u bëfsh si ara me grurë-urim. paç shumë fëmijë; u shtofsh. ❖ i ka arat pas lumit dikush-është në gjendje të mirë ekonomike. ❖ ara e mirë nuk mban gjemba- fj.u. thuhet për dikë që është i ndershëm dhe i drejtë e që nuk i duron padrejtësitë. ❖**

pyet ara me thekër se bëjnë fëmijët pizga-shak. nuk ka pse të kursehet, kur ka bollëk.

13.3. Emërvendet dalin si elemente të mikrostrukturës së një fjale së bashku me frazeologjinë (d.m.th., pa shpjegim kuptimor të fjalës titull):

gúr,-i m. (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Guri i Arapit; Guri i Barçarit; Guri i Bardhë; Guri i Capit; Guri i Cuculit; Guri i Cutes; Guri i Cyrylyng; Guri i Dhelprës; Guri i Grijës; Guri i Kalamit; Guri i Korbit; Guri i Lig; Guri i Madh; Guri i Madh de Klishtë; Guri i Milkës; Guri i Mustafa beut; Guri i Nuses; Guri i Shpuarë; Guri i Shqiponjës; Guri i Vjeshtës; Guri i Vogël; Guri i Zez; Guri i Zëres; Guri i Zonjës*). ❖ *i ka rënë guri dhe opingët* dikujt - ka shumë halle, vuan shumë. ❖ *i ra guri e i theu këmbët* dikujt - e zuri një hall i madh. ❖ *bluan edhe gurë* dikush - është i fortë nga dhëmbët. ❖ *s'ka dalë pe gurit* dikush - nuk është i vetëm, ka njerëz të afërm që e duan. ❖ *di ku e nget gurë* dikush - është i zgjuar dhe dinak. ❖ *e duan edhe gurët e sokakut* dikë - është njeri shumë i mirë. ❖ *fol o gur, fol o dru (o gur)* - nuk nxjerr asnjë fjalë, është i heshtur. ❖ *s'gjen një gur t'i biesh qenit* - është tokë shumë e thatë. ❖ *hodhi gur* dikush - nuk ka ardhur asnjëherë (për dikë që vjen rrallë). ❖ *hedh një gur dhe lumët* - bëj një përçapje, them edhe unë një fjalë, e provoj një herë. ❖ *hodhi një gur prapa* - u betua se nuk do të vijë më. ❖ *e kaloj guri masatin* - përdoret për dikë që flet a bën veprime të tepërta para më të mëdhenjve e kaloj bishti sqeparin. ❖ *guri i math bi të voglin* - le të bëhet ç'të bëhet, të dalë ku të dalë. ❖ *s'la gur pa lëvizur* dikush - përpiket me të gjitha mënyrat për t'ia arritur qëllimit. ❖ *mat gurët e sokakut* dikush - keq. rri kot, nuk bën asgjë. ❖ *mbeti si guri në udhët* dikush - është i vetmuar, nuk ka njeri. ❖ *më ka zënë guri këmbët* s'lëviz dot, nuk di nga t'ia mbaj; ❖ *pëlçet edhe gurin* dikush - është kokëfortë. ❖ *qajnë edhe gurët e sokakut* për dikë - e donin shumë. ❖ *ia shpuri gur - gur* dikujt - e mërziu shumë, ia nxori për hundësh. ❖ *si guri në udhët* - i vetmuar, pa njeri. ❖ *gur zënç, flori të të bëhet - urim. u begatofsh, u pasurofsh.*

13.4. Emërvendet dalin si elemente të vetme të mikrostrukturës së një fjale (d.m.th., nuk ka as shpjegime kuptimore të fjalës titull, as njësi frazeologjike edhe pse fjala mund të ketë aftësi të mëdha shndërrimi të figurshëm dhe ngjizjeje njësisht të tilla). Më poshtë po japim tri grupe njësisht për të treguar vendin e këtyre emërvendeve në Fjalor, por dhe punën e autorit për të mbledhur sa më shumë të tilla:

Te fjala *çezmë* gjejmë 61 emërtime: **çézm/ë,-a f.** (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Çezma e Amzës; Çezma e Ballabanit; Çezma e Banushit; Çezma e Bardhë; Çezma e Bariqit; Çezma e Bregut të Lumit; Çezma e*

Buzhinës; Çezma e Dautit; Çezma e Demirit; Çezma Dollma; Çezma e Elesheve; Çezma e Fermës; Çezma e Fshatit; Çezma e Furrës; Çezma e Ganos; Çezma Gorna; Çezma e Gruçkave; Çezma e Gjarpërit; Çezma e Hajdutëve; Çezma e Hake Hedijes; Çezma e Hasanit; Çezma e Hysit; Çezma e Imbrijes; Çezma e Kaçkës; Çezma Kaçunari; Çezma e Kalimshes; Çezma e Kallbaqit; Çezma e Kaurëve; Çezma e Kolimbrave; Çezma e Kolit; Çezma e Kreakut; Çezma e Kuralinave; Çezma e Lames; Çezma e Lileve; Çezma e Madhe; Çezma e Mekamit; Çezma e Merasë; Çezma e Metes; Çezma e Mimiut; Çezma e Minierave; Çezma e Moçalit; Çezma e Nikës; Çezma e Përçekut; Çezma e Pijave; Çezma e Plepit; Çezma e Poganecit; Çezma e Rakitave; Çezma e Sabriut; Çezma e Slllogjeve; Çezma e Stallave; Çezma de Stenat; Çezma e Shkallës; Çezma e Varreve; Çezma e Verinjve; Çezma e xha Eminut; Çezma e xha Jasharit; Çezma e xha Halilit; Çezma e xha Sadikut; Çezma e xha Sulit; Çezma e Xhakes; Çezma e Xhamisë). ❖ *të shpie dhe shtatë çezma e s'të jep ujë dikush - është shumë i zgjuar; ta hedh kur të duash.*

Te fjala *breg* gjejmë 40 emërtime: **brég,-u** m. (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Bregat; Bregjet; Brigjet; Bregu i Bardhë; Bregu i Beqir Qoses; Bregu i Devolliut; Bregu i Gaziut; Bregu i Gjërë; Bregu i hoxhë Zarifit; Bregu i Hysenit; Bregu i Kaçkës; Bregu bi Klishë; Bregu i Kunjishtës; Bregu i Llabanit; Bregu i Madh; Bregu i Manit; Bregu i Merasë; Bregu i Mesëm; Bregu i Muzgës; Brigjet e xha Nazarit; Bregu i Ogozhdit; Bregu i Padinave; Bregu i Përroit të Ngrohtë; Bregu Rakullogje; Bregu i Selishtës; Bregu i Sokobërcës; Brigjet e Sokolinove; Bregu mbi Përroin e Thatë; Bregu i Pitos; Bregu i Shahinit; Bregu i Shegurit; Bregu i Shkallës; Bregu i Udhës së Çarë; Bregu i Varrit të Kasos; Bregu i Vreshtëve; Bregu i xha Nurkës; Bregu i xha Selmanit; Bregu i xha Sulkës; Bregu i xha Xhemos; Bregu i Xhafit; Bregu i Zenelit; Bregu i Zhinës)*

Te fjala *burim* gjejmë 34 emërtime: **burím,-i** m. (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Burimi i Arave të Malos; Burimi i Cërkaviqit; Burimi i Dheut të Pekmezit; Burimi i Evgjinit; Burimet e Ftohta; Burimi i Furkës; Burimi i Fushës; Burimi de Kalivja; Burimi Kallogje; Burimi i Karafilit; Burimi i Kërcurit; Burimi i Koligjinit; Burimi i Koxhave; Burimi i Lëndinave; Burimi de Luadhi; Burimi i Luadhit; Burimi i Merrizit; Burimi Orej; Burimi de Plloça; Burimi i Sefes; Burimi i Selimit; Burimi i Sellcave; Burimi de Sinia; Burimi i Sivakut; Burimi i Stranes; Burimi i Sheros; Burimi i Shopit; Burimi i Tremisurkave; Burimi i Vëntrokut;*

Burimi Vidhe; Burimi i Vreshtkave; Burimi i xha Donit; Burimi i xha Sadikut; Burimi i Zalos; Burimi i Zvorrit).

Te fjala *grykë* gjejmë 18 emërtime: **gryk/ë,-a f.** (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Gryka e Çezmës së Hysit; Gryka e Dollit; Gryka e Gornicës; Gryka e Hijeve; Gryka e Kalimanicës; Gryka bi Kapshticë; Gryka e Korijs; Gryka e Kuajve; Gryka e Lapishtes; Gryka e Magjarit; Gryka e Prevalit; Gryka e Prislenskës; Gryka e Qafkës; Gryka e Qershizave; Gryka e Shkollës; Gryka e Toplecit; Gryka e Ujkut; Gryka e Ulicave).*

14. Elemente të etnokulturës

Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit sjell në faqet e tij dhe një lëndë të bollshme që lidhet me etnografinë e të folurit. Zakonisht kjo lëndë është pasqyruar pranë strukturës kuptimore të një zëri leksikografik, sidomos kur janë emërtime dy- e më shumëgjymtyrëshe. Por nuk mungojnë rastet kur dalin dhe si fjalë titull.

Në vijim po sjellim disa grupime njësisht që lidhen me etnokulturën:

14.1. Fjalë të urta: ❖ *oxhaku s'bëhet buxhak* - fj. u. një gjë e mirë mbetet e tillë; ❖ *buka s'ka turp* - fj. u. i thuhet dikujt që është i turpshëm dhe nuk ha asgjë kur vete diku; ❖ *kush i bën kulaçet e shtrembra, nusja* - fj. u. përdoret me ironi për të kritikuar mendimin se gabimet i bëjnë më të vegjlit; *po u thye kulaçja, nuk ngjitet* - fj. u. po e prishe keq me dikë, vështirë se rregullohet.

14.2. Urime: ❖ *të paçim sa malet!* - urim. paç jetë të gjatë; ❖ *i ndritë barku që e ka mbajtur* - urim. thuhet për dikë që është shumë i mirë dhe zemërbardhë.

14.3. Betime: *për këtë bukë!* - bet. kur thuhet diçka e vërtetë.

14.4. Mallkime ❖ *març malet!* - mallk. u çmendsh! ❖ *të rëntë alivani!* - mallk. e pësosh; ❖ *mos arriç e mos mbeç!* - mallk. vdeksh!; ❖ *thefsh arrëzën e qafës!* - mallk. vdeksh!; ❖ *mos arrifsh të bëhesh!* - mallk. vdeksh, mos u bëfsh. ❖ *mos të rëntë dë barkt!* - mallk. mos u ngopsh!; *dë barkt mbajç, bë pëqit mos paç!* - mallk. lindsh dhe të vdektë fëmija; ❖ *gjeç belanë!* - mallk. e pësosh; ❖ *mos të rëntë dë brit* - mallk. mos u ngopsh; ❖ *të zëntë buka ime!* - mallk.përdoret për një njeri mosmirënjohës; ❖ *të piftë bukla!* - mallk. vdeksh! *mos të kukittë gjë!* - mallk. mbetsh pa gjë, mos të mbiftë asnjë gjë; ❖ *të daltë lugati!* - mallk. e pësosh!; ❖ *u djegç lugat* - mallk. vdeksh! ❖ *të mbledhtë ai lart!* - mallk. vdeksh!; ❖ *të mbledhtë e mos të ktheftë!* - mallk. vdeksh!

14.5. Sharje: ❖ *të dhjefsha mustaqet!* - thjeshtligj. sharje për një burrë që mban mustaqe.

14.6. Elemente të etnokulturës apo të mendësisë popullore për frymorë, sende, veprime, marrëdhënie etj., që pasqyrojnë fjalori, duken drejtpërdrejt dhe në mikrotoponimet si emërtime të pathjeshta. Po sjellim si ilustrim emërtimet me *mal*. Në Devoll mund të jenë vërtet dy-tre male, por populli quan *mal* edhe lartësi kodrinore: **mál,-i m.** (edhe si gjymtyrë emërvendesh: *Mali i Babovicës; Mali de Bleta; Mali i Brinjës; Mali de Bushka; Mali i Dardhushkës; Mali i Gornicës; Mali i Grekut; Mali i Grendes; Mali nga Gria; Malie de Gropa; Mali i Gumenit; Mali i Gurit; Mali i Hijes; Mali Jonë; Mali i Kakaçit; Mali i Kallogjerit; Mali i Kopaçes; Mali i Korbecit; Mali i Kulirave; Mali i Kunjës; Mali i Kuq; Mali i Mashores; Mali i Namigës; Mali i Osojit; Mali i Qoses; Mali i Rirave; Mali de Sëndyqi; Mali i Stranës; Mali Sfrat; Mali i Shullërit; Mali de Shurishta e Zezë; Mali i Turirit; Mali i Thatë; Mali i Vipjakut; Mali i Zhupanit; Mali mbi Xhami etj.).*

14.7. Elemente të etnokulturës së krahinës së Devollit mund të shpërfaqen dhe në zërat e zakonshëm leksikografikë. A. Jashari ka mbledhur shumë emërtime festash, gatimesh etj. që na lidhin me këtë fushë të jetës së devollinjeve, duke e plotësuar kuptimin e njësisë së dhënë dhe me elementin plotësues *etnog.* (etnografi). Po ilustrojmë.

arúshk/ë,-a II f. *etnog.* lloj bukuvaleje që bëhet për Vitin e Ri: Mbrëmjen e Vitit të Ri gatuajnë një lloj bukuvaleje me miell të grunjë, të pjekur në tepsitë e të dërrmuar pastaj, të cilën e quajnë arushkë dhe para se ta shtrojnë për ta ngrënë në darkë e lënë një hop prapa portës së jashtme të shtëpisë “që ta hajë arushka”. (V. Xhaçka).

15. Onomatopetë

Sistemësinë dhe plotërinë e lëndës së vjelë dhe të pasqyruar në Fjalor e tregojnë dhe grupi i tingullimitimeve. po ilustrojmë:

bam *onomat.* përdoret për zhurmën e një pushke a të diçkaje tjetër: *Vjerra folë / ti mos folë/ se ti gam/ qoteku bam.* (K. Zdruli, FDS). ❖ *ia bëri bam* dikush - *shak.* u fejua a u martua më në fund.

bëz *onomat.* ❖ *i bën mendja (koka) bëz* dikujt-ka shumë ngarkesë mendore; i duhet që të merret me shumë punë.

cim-cím *onomat.* lojë fëmijësh duke vënë këmbyerazi duart njëri mbi tjetrin e duke i pickuar nga sipër.

16. Dukuri morfologjike

Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit ka sjellë mjaft lëndë ku mund të ndiqen dhe dukuri e procese fjalëformuese dhe ato eptuese.

16.1. Dukuri që lidhen me morfologjinë e fjalëformimit

16.1.1. Dukuri të formimeve me prejardhje. Nuk mbetet nga ne synim të ndalemi gjerësisht në çështjet që mbulon ky koncept. Po theksojmë shumë shkurt se në vepër janë me qindra fjalët e formuara me prapashtesimin. Të tërheqin vëmendjen formimet me prapashtesa zvogëluese e sidomos ato me prapashtesa të huazuara nga gjuhët sllave (maqedonisht-bullgarishtja etj., si -kë, -icë etj) apo formimet me prapashtesat e modifikuara (me elemente të huazuara dhe shqipe), formimet me prapashtesat të emrave të gjinisë femërore nga emrat e gjinisë mashkullore etj. Formimet me prapashtesa krijojnë një hapësirë për një studim tjetër më të gjerë dhe me të thelluar.

Pa hyrë në analiza të tjera të hollësishme, po sjellim disa shembuj:

ziçishtárk/ë,-a f. ajo që banon a e ka prejardhjen nga fshati Ziçisht i Devollit: *kapshticarka, kufitarka/ ziçishtarka, me litarka/ vërlenarka, moj poçarka.* (K. Zdruli, FDS).

ziçishtár,-i m. ai që banon a e ka prejardhjen nga fshati Ziçisht i Devollit: *Y, o trima, o ndardharë/ mbillni kripë, o sinicarë/ lakraxhinj, o qytezarë/ qafëgjym, o ziçishtarë.* (K. Zdruli, FDS).

lavrúshkë mb. e shkathët, e shpejtë. / **lavrák mb.** keq. i shkathët, dinak

kumbulléck/ë,-a f. kumbull kokërrmadhe, e gjatë dhe e kuqe.

arífic/ë,-a f. gruaja e Arifit. ❖ *si Arifegjyni para Bajramit - tall.* thuhet kur një i vogël në moshë del para më të madhit.

16.1.2. Disa formime me prapashtesat zvogëluese

frónk/ë,-a f. karrige e vogël pa mbështetëse: *Kur ishte mot i ngrohtë, ajo merrte një fronkë të sheshtë dhe ulej te pragu.* (Th. Jorgji, PD). ❖ *e vuri bë fronkët dikë - i kërkoi llogari deri në një; ia futi këmbët në një këpucë.*

véçk/ë,-a f. vezë e vogël prej jariçe: *Merr veroren, ver bë kleçkë/ për pashkë sill buk' e veçkë.* (Koçillari, TShD). ❖ *është me veçkë dë bythët - thjeshtligj.* është i pasur, në gjendje të mirë ekonomike.

ftújk/ë,-a f. përkëdh. ftujë: - *Me zile, moj ftujk' e bardhë/ bëje çapen me ngadalë.* (K. Zdruli, FDS).

ftújkëz/ë,-a f. përkëdh. ftujë: Ftujkëz e bardha me zile/ rrugës së malit kur vije/të dy cickat m'i djersije. (D. Agolli, NjK).

fúndk/ë,-a f. 1. përkëdh. fund i vogël, zakonisht për fëmijë: *sa mirë i rri fundka.* 2. gjethet e vogla të duhanit afër rrënjës: *tashi po mbledhim fundkat.*

fundáçk/ë,-a f. fundkë.

fustánk/ë,-a f. fustan i vogël: *Moj e holla porsi bari/ e kulluara si ari/ vishe, moj, fustankën/ vishe, moj kollankën.* (K. Zdruli, FDS).

16.1.3. Disa formime me prapashtesa me kuptim intesiv

Fshe(h)uríçk/ë,-a 1. lloj loje për fëmijë. 2. diçka e fshehtë: *Sime shoqeje i pëlqen të bëjë gjithnjë fshehuríçka, i pati shkuar ndërmend atë natë.* (Th. Naqo, M). ❖ *i dolën fshehuríçkat dikuajt - zbulua, ia morën vesh të gjitha të fshehtat që mbante.*

fukaráçkë mb. shumë e varfër: *Na ish mos na ish, një grua fukaraçkë ish, tri çupa të bukura na kish.* (K. Zdruli, FDS).

16.1.4. Formime me përbërje

gojafrátë mb. që flet shumë dhe nuk respekton më të mëdhenjtë.

gojasllánk/ë,-a f. lloj luleje.

gojëfëllëg/ë,-a f. ai ose ajo që nxjerr gjithnjë fjalë të hidhura: *Kushedi, do ketë bërë fjalë me atë gojëfëllëgën, mendoj.* (T. Laço, M).

gojëjamáçkë mb. që flet shumë, llafazan.

gojëkllópáshkë mb. llafazane: *Moj krushka, leshrat me mashka/ ç'qëni kaq gojëkllópashka/ mos e bëni gojën mashë/ lejën e kemi me pashë!* (K. Zdruli, FDS).

gojëmáshë mb. llafazan.

gojëmastrapá mb. që e ka gojën të madhe, jo në përmasat e zakonshme.

gojëmëmëliqe mb. që nuk flet një fjalë, që nuk kundërshton.

gojëmjáltë mb. që thotë fjalë të mira e nuk shan kurrë: *Punëtore e fort' si bleta/ gojëmajt' e krahëlehta.* (Koçillari, TShD).

gojëshafrá mb. që thotë vetëm fjalë të hidhura, që flet vetëm ters: *Informatorët këmbëngulnin se Mizëkalovica ishte gojëshafra.* (Th. Naqo, PI).

gojëze(h)ér mb. keq. që ndjell vetëm ters; që lëshon vetëm fjalë të hidhura.

gojëxhy(h)ér mb. keq. që nxjerr xhevahire nga goja.

16.1.5. Formime me përngjitje:

drek(h)ér/ë,-a f. koha e drekës: *Kur vinte ora të zbrisnin malaxhia nga drekhera, bëhej furtunë.* (A. Andoni, N).

dykmeqënë lidh. meqenëse: *Dykmeqënë kështu, le të ikin*

16.1.6. Formime me paranyjëzim

gajásur (i, e) mb. 1. i lodhur nga të qarët e shumtë a nga puna e rëndë: *Por më vështroi me sy të çapluar, si i gajasur.* (S. Andoni, ShShN). 2. i stërmunduar, që nuk ka më fuqi të punojë: *Si u janë dërrmuar sëpatat, të gajasur e të mahnitur, kanë rënë përdhe.* (S. Andoni, FKQ).

gjezdisur (i, e) mb. i shëtitur, i bredhur, që ka shkuar në shumë vende të tjera, që ka parë shumë: *Haxhi Çulla pat dëgjuar ca histori të çuditshme nga një plak i gjezdisur gjer në Rusi.* (A. Andoni, N).

16.1.7. Formime me ndërrim të kategorisë leksiko-gramatikore (konversion)

ballabán,-e mb. që është tërë shëndet e me trup të madh: - *Plakë ballabane!* - *tha Todo Çali që ish afruar.* (T. Laço, M); *Sterjovica në të ritë e saj ishte e gjatë dhe ballabane në trup, tamam dardhare!* (Th. Jorgji, PD). Khs. me **ballabán-i** m. mit. ariu që e shëtisin për të zbavitur njerëzit (edhe si emërvend: *Ballabanët*): *Ç'ka ky sot, sikur i ka ngrënë ballabani brumët?* - *tha Iliri me vete.* (A. Andoni, T). ❖ *sikur i ka ngrënë ballabani brumët* dikujt-i mërzitur.

16. 2. Dukuri nga morfologjia e eptimit / spektri gramatikor i njësive

Në Fjalor gjejmë të gjithë spektrin e njësive leksikogramatikore. Kjo është një tjetër prurje e veprës (shpesh fjalorët dialektorë u japin përparësi fjalëve kryesore quajtëse: emra, mbiemra, folje ndajfolje).

Emra: lakrór,-i m. gatesë brumi me dy petë dhe me gjellë brenda: *Ma bëje lakrorë/ Përsipër të djegur/ Kush t'i prishka mendtë/ Gështenjë e papjekur.* (D. Agolli, ShGh). ❖ *lakror me dëborë* - diçka që s'bëhet. ❖ *lakrorin që s'e ha për vete le të digjet megjithë saç* - thuhet për dikë që sheh vetëm interesin vetjak, që s'pyet e s'mendon për të tjerët. ❖ *është si lakror i pjekur bë djellt* - i papjekur mirë. ❖ *e nis lakrorin nga mesi* dikush - tall. nuk e fillon mbarë një punë.

Mbiemra: korbéckë mb. pa njeri, e vetmuar (vajzë, grua): *Po ç'të gjeti, moj korbeckë.*

Folje: gagarít fol. qesh me të madhe, hargaliset: *Disa vajza të repartit të thurjes vrapuan përmes sheshit duke gagaritur.* (Th. Naqo, PI).

gajás fol. 1. i bie të fiktë nga të qarët. 2. qesh me të madhe; shkulet së qeshuri: *Për një çast ajo u qetësua, pastaj vrapoi nëpër sallë duke u gajasur.* (D. Agolli, TG). 3. lodhet shumë, stërmundohet.

buít fol. 1. punon shumë; përpiket tërë ditën për të bërë diçka, lodhet, mundohet. 2. del, shpërthen: *Pranvera livadhiste dhe e buiste duke u ngjitur shpejt e më shpejt pas kodrës.* (T. Laço, TZ).

Ndajfolje: andéjza ndajf. andej, në anën tjetër.

andéjzanit ndajf. andejza, andej, në anën tjetër.

Numërorë: dy num. ❖ *i ra dy bë tri* dikush-e bëri pa kujdes diçka.

Përmera: ajó për. euf. gruaja. ❖ *thoji asaj tëndes, t'i thotë asaj simes* - lojë fjalësh nga burrat për të lajmëruar gratë e tyre lidhur me diçka.

Parafjalë: *bë paraf. në: vajti bë dasmë; do të vimë bë shtëpit.*

Pjesëza: *allasëndëk pj.* përdoret kur dyshojmë se mos ndodhë diçka e keqe: *Allasëndëk, mos e dhëntë Zoti!*

Pasthirrma: *ájs!* pasthirmë për të nxitur qetë që të vazhdojnë punën: - *Mbarë të na i bëjë Zoti! Ajs! Hiqi qetë, bir!* (S. Hoxhalli, F).

amán (amáni)! *pasth.* të (ju) lutem! përdoret për të shprehur një lutje, një kërkesë, mëshirë etj.: *Amani, o shokë, hallin ce s'ma qani.* (KPRrK); *Hiç për gjë s'të kam zili/ moj, aman, moj, oi.* (K. Zdruli, FDS).
2. përdoret për të theksuar diçka nga pakënaqësia: *aman, sa i lig që je.* ❖ *për aman o zot-shumë keq.*

ejvallá(h) *pasth.* faleminderit!

17. Dukuri fonetike

Një fjalor dialektor, që sjell dhe jetën e fjalëve me shembuj nga ligjërimi të ndryshme, krijon mundësi të shumta për të sipërmarrë edhe studime fonetike. Kështu ndodh dhe me Fjalorin leksiko-frazeologjik të Devollit.

Po japim disa dukuri fonetike që vërehen në këtë vepër

17.1. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve në fund: my(h)ýp,-i (për myhib) *m.* ndjekës i sektit alevijan.

17.2. Përdorimi zanores ë në vend të e - së para bashkëtingëlloreve hundore:

mënt *v. sh. mend.* ❖ *i hëngri (i piu) mëntë* dikush - bën veprime të pakontrolluar; nuk di se ç'bën. ❖ *jak ndër mënt* - eja në vete, mblidhe mendjen, mos fol ashtu. ❖ *i ka mëntë për lëmpjeta* dikush - keq. nuk shtrohet në një punë. ❖ *nuk vë mënt* - vazhdon të bëjë diçka megjithëse e pësoi. ❖ *i venë mëntë rrotkë* diku - i merren mendtë. ❖ *aq mënt ka, aq zemëroju* - fj. u. mos ia vër veshin.

17.3. Një nga dukuritë fonetike më të spikatura në fjalësinë e Fjalorit (e jetën e fjalëve të këtij fjalësi) është **ruajtja (nyjëtimi) / mënjanimi i bashkëtingëllores grykore h** në pozicion nistor, por dhe në një rrethim fonemor zanor (h-ja midis dy zanoreve), madje edhe kur ndiqet nga një bashkëtingëllore tjetër, si **a(h)metlíu** patronim, llogap; **A(h)mét,-i m.** **m.A(h)metíc/ë,-a** gruaja e Ahmetit.), por edhe në atë fundor: **allá(h),-u m.** Zoti. ❖ *është Allau na ruajtë* dikush - është i çuditshëm; nuk merret vesh se çfarë thotë e çfarë bën; **allá(h)-allá(h)!** *pasth.* mos o Zot!

Shembujt janë me qindra në Fjalor. Autori i veprës e ka paraqitur të futur në kllapa këtë tingull / fonemë. Mjafton t'u referohemi zërave leksikorë të shkronja H për ta parë të paktën dukurinë e **ruajtjes**

(nyjëtimimit) / mënjanimimit (mosnyjëtimimit) të saj, dukuri që ndeshet dhe në areale të tjera gjuhësore të shqipes jugore.

(h)údh/ër, - ra f. ♦ është bërë për me hudhra dikush - ka mbetur kockë e lëkurë. ♦ është bërë si hudhër e shurdhuar dikush - nuk ka fuqi fizike, është shumë i dobët fizikisht. ♦ nuk hahet as me hudhra, as me uthull dikush - nuk durohet, është i bezdisshëm; e ka mbushur kupën me ato që thotë e bën. ♦ mbaj hudhër! - i thuhet dikujt që është shumë i bukur për të mos e marrë mësysh të tjerët. ♦ mban hudhër pas dikush - iron. është shumë i shëmtuar. ♦ t'i mbin hudhrrat për prapë - keq. është njeri i lig. ♦ shtyp hudhra dikush - e kalon kohën kot. ♦ t'i shtypësh hudhra (bë kokët) dikujt - është njeri shumë i duruar. ♦ shtyp hudhra dë kokën e tij dikush - i bën të keqen vetes.

(h)ukás fol. 1. fryj duart për t'i ngrohur: *U nis drejt stallave atë mëngjes dimri, duke u mbajtur pas gjerdheve të rrugës dhe duke sharë "Siberia e m.. m.. utit" e hukiste duart e ngrira.* (A. Andoni, T). 2. lëshoj ajër të ngrohtë nga goja: *Kurrizi preku murin e lëmuar të ahurit dhe dhia ia afroi turinjte që hukatnin mbi të saj.* (A. Andoni, N).

(h)umaí, - ja f. kambrik, puplinë.

(h)umbaméno mb. i hutuar, i shushatur, i humbur.

(h)úmb/ë,-a f. baltë argjile që përdorej për të larë flokët (edhe si emërvend: *humbë; humbat*).

(h)umbëtír/ë,-a_I f. vend që ka humbë.

(h)umbëtír/ë,-a_{II} f. thellësirë, vend i shkretë: - *Hy, të plastë kungulli. nga vjen ti, nga humbëtirat, - tha kapteri.* (T. Laço, M).

(h)úmbur (i, e) mb. i mefshtë, i pazoti, që ia hedhin të tjerët.

(h)únd/ë,-a f. ♦ ra bë hundë dikush - e pësoi keq. ♦ t'i bjerë hunda përdhe nuk e merr dikush - iron. është mendjemadh. ♦ iu ça hunda - nuk duron dot pa pirë duhan. ♦ më ha hunda - thuhet kur dikush parashikon se do të zihet me dikë. ♦ sikur e ka hequr pe hunde dikë - i ngjan shumë; sikur janë njëlløj. ♦ nuk e lë hunda dikë - është mendjemadh; e mban hundën përjetë. ♦ hunda e madhe belaja e të zot - fj. u. thuhet për dikë që e ka hundën të madhe. ♦ sikur e ka nxjerrë nga hundët dikë - i ngjan shumë; sikur janë njëlløj; sikur e ka hequr për hunde. ♦ ia nxori për hundësh - nuk e la rehat; e shqetësonte vazhdimisht në një festë etj. ♦ qesh hunda buzën - iron. thuhet për dikë që tall të tjerët dhe nuk sheh veten. ♦ i rri hundëve dikujt - nuk ia zgjat; i kërkon vazhdimisht llogari. ♦ ta zësh për hunde i del shpirti (xhani) - është shumë i mërzhitur.

(h)undëgogozhdáre mb. që e ka hundën të madhe e të shtypur.

(h)undëgjat/ë,-i *m.* lloj insekti dëmprurës që ha kokrrat e panxharit nën tokë; quhet kështu se e ka hundën të gjatë: shumë vetë e ngatërruan refugjatin me hundëgjatin që dëmtonte panxharin. një brigadier, duke sqaruar situatën para punëtorëve, tha: “*Le të ikin, le të ikin, se në një kamp me hundëgjatë i kanë mbyllur! se hundëgjati ia ha t’ëmën panxharit, jo njeriut!*” (H. Lilo, O).

(h)undëlësh *mb.* trim e kokëkrisur: i ngjeshur e hundëlesh, ai i mbante sytë gjysmë të mbyllur. (t. laço, p). ❖ *gjer të bjerë bë ndonjë hundëlesh* - do ta pësojë ndonjë ditë.

(h)undësamar *mb.* që e ka hundën të kërcyer si samar.

(h)undësëz *mb.* që rri i mërzhitur, i vrenjtur.

(h)undësqpër *mb.* që e ka hundën të hollë.

(h)undëz,-a *f.* rrjetë prej litari a teli që u vihet kafshëve të samarit a qeve për të mos ngrënë ushqim kur janë të ngarkuar a kur punojnë në arë.

(h)undëzaj *ndajf.* duke u mbështetur më hundë: *Kali u përplas më hundëzaj bri rrugës.* (S. Andoni, MSh).

(h)up *f.* humb, nuk e kam më: *Ce kanë florinë/ ce kanë paranë/ ma hupnë të rinë/ ma hupnë sevdanë/ mbeta un’ e mjera me kokë mënjane!* (Koçillari, TShD).

(h)uq,-i *m.* zakon, tabijat: ne jemi me huqe, agush. (D. Agolli, NjK); Dëgjo, tani, po mos ma pre fjalën, siç e ke huqin. (T. Laço, TSh). ❖ *iu shtuan huqet si të mushkës plakë* dikujt - i ka shtuar veset, grindet kot.

17.4. Rënia e tingujve:

17.4.1. rënia e tingujve në ballë të fjalës (aferezë):

alk/ë,-a *f.* gozhdë e vogël për të mbërthyer këpucët etj. (halë - halkë)

17.4.2. Rënia e tingujve në trup të fjalës (sinkopë):

mer(h)umk/ë,-a *f.* e ndjera, merumka: *Kjo më kujton atë merumkën, nënën time.* (D. Agolli, NjT).

mu(h)abët,-i *m.* bisedë, pritje miqsh e shokësh: *Të takoj shoqet bë rrugë / se ato kanë muhabet shumë.* (KPRrK). ❖ *nuk i hahet muhabeti* dikujt me dikë - nuk flasin. ❖ *muhabet ngaherë!* urim. ❖ *pika o Amet me kë bëj muhabet* - thuhet me shaka për dikë që nuk merr pjesë në bisedë.

a(h)isht/ë,-a *f.* dru ah: *E rrëmbeu Manok aganë / E lidhi me dy ahishta / dy ahishta brinjës lart / Manok agai mbet në çark.* (Koçillari, TShD).

17.4.3. Rënia e tingujve në fund të fjalës (akopë):

mja *ndajf.* mjaft: *O trëndafili me fletë/ pa ngrehu se mja na fjete.* (KPRrK).

kúsh/o,-ua m. përkëdh. kushëri: *Ja sa t'i ndodhesh kushos për ndonjë urdhëratë.* (S. Andoni, MSh).

17.4.4. Rënie e shtimi i tingujve:

a(h)érnaj ndajf. atëherë, në atë kohë.

17.4.5. Rrëgjimi i tingujve: lëftój fol. luftoj: *Ca këndonin, ca vajtonin/ për ca trima që lëftonin/ lëftonin Korfus kalanë.* (Koçillari, TShD).

17.5. Shtimi i tingujve

17.5.1. Shtimi i tingujve në fillim të fjalës:

javásh ndajf. ngadalë, butë, lehtëzi: - *Javash, javash, or i bekuar/ javash mos m'i shkel rrathët!* (D. Agolli, P).

javashllëk,-u m. të qenët i javashëm, ngadalësi, mefshtësi.

javásh/ëm,-me(i, e) mb. që nuk punon a nuk ecën shpejt.

17.5.2. Shtimi i tingujve në trup të fjalës

dam(b)llá,-ja f. damlla, sëmundje e rëndë që vjen nga gjakrrjedhja në tru ose nga mpiksja e gjakut në enët e trurit dhe që shkakton menjëherë humbjen e ndjenjave dhe pushimin e lëvizjeve, pikë: 2. *fig.* fatkeqësi e madhe a goditje e rëndë dhe e papritur. ❖ *i ra damblaja* dikujt - *keq.* vdiq, shkoi me të shumtët. ❖ *të rëntë damblaja!* - *mallk.* vdeksh!

dimbër: *s'i bën koka dimbër* dikujt - nuk i bëhet vonë për asgjë, nuk shtie merak; e merr jetën si t'i vijë.

17.5.3. Shtimi i tingujve në fund të fjalës

atjéth ndajf. atje: *Në mos mësofsha të mbledh/ të më lini shoqe atjeth.* (Koçillari, TShD).

gomart: *hiq nga ana vër bë samart.*

pust: - *Ç'ka imzot që ronit lot?/- Ce i ra mëhyri dë pust.*

tavant: *ta kam bërë kokën bë tavant* - të kam lindur e të kam rritur kaq, kam bërë shumë sakrifica për ty (i thuhet një fëmije që është mosmirënjohës)

17.6 Ndërrimi i tingujve homoorganikë me njëri-tjetrin, si l me j:

álk/ë,-a₁ f. ajkë, kajmak. ❖ *ia mori alkën* diçkaje - ia mori pjesën më të mirë. ❖ *e ka rritur me alkën e qumështit* dikë - e ka ushqyer me gjithë të mirat.

alkóset fol. zë një cipë të hollë në sipërfaqe pas zierjes, njëlloj si ajka e qumështit: *u alkosën fasulet.*

alkósur (i, e) mb. që është zier mirë e ka zënë një cipë të hollë përsipër: *gjellë e alkosur; fasule të alkosura.*

17.7. Disimilim tingujsh:

aluríj fol. ulërij, lëshoj britma; thërras me të madhe: *Kur shikoj, oj nënë, na, lumenjt' e zinj/ alurijnë gra, oj, alurijn' fëmi.* (K. Zdruli, FDS); *Zunë dhentë blegërinin/ zunë qentë alurinin.* (K. Zdruli, FDS).

alurím/ë,-a f. ulërimë; britmë: *lëshon alurima.*

17.8. Asimilim tingujsh:

(**alleman** → allaman) **allamán,-i** m. gjerman.

(allosoj → allasoj) **allasój** mb. 1. i ndryshëm nga të tjerët, i çuditshëm: *Unaza ishte allasoj, e paparë.* (T. Laço, M). 2. i luajtur nga mendtë: *është allasoj, mos e dëgjo.*

17.9. Metatezë

dobéc,-i m. 1. thumb i metaltë, bodec: *Panua iu kthye me dobec gomarit dhe ia bëri vithet copë.* (S. Andoni, TZ). 2. shkopi i skive: *S'ke nevojë fare t'u japësh dobecëve.* (Th. Jorgji, PD). ❖ *e do (e ka) me dobec* dikush-nuk ka iniciativë; duhet nxitur gjithnjë për një punë. ❖ *s'ha dobec* dikush-nuk merr vesh, nuk kupton, është i trashë nga mendja.

18. Lëvizje theksi:

fustané,-ja f. fustanellë: *Fustanenë korbë që të djalërisë / dridhe, Malo, dridhe kazan' e Ohrisë!* (Koçillari, TShd).

19. Marrëdhëniet leksiku dialektor – leksiku i shqipes standarde

19.1. Fjalë që pasurojnë leksikun normativ

Vepra *Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit* pasuron me dhjetëra e me qindra njësi të reja fjalorin e shqipes standarde. F.v., **hundëzāj** ndajf. duke u mbështetur më hundë: *Kali u përplas më hundëzaj bri rrugës.* (S. Andoni, MSh).

kalúshk/ë,-a f. skelë e vogël që përdoret për ndërtim.

Njësitë që (duhet) zënë vend lehtësisht në leksikun normativ, përgjithësisht janë njësi jo të parme, por nuk mungojnë dhe ato të parmet, zakonisht kur i përkasin botës materiale.

Në vazhdim po sjellim disa fjalë të përbëra me *kokë, bark, turi, vetull*, që dalin për herë të parë në një vepër leksikografike (duhet të ritheksojmë se fjalët e përbëra në Fjalor krijojnë një grup shumë të madh dhe mundësojnë një studim të plotë në të ardhmen).

kokëbërdíllë mb. keq. që e ka kokën sa një bërdillë; kokëmadh.

kokëbërxiík mb. keq. që e ka kokën sa një bërxiik; kokëmadh.

kokëbozúk mb. keq. kokëbuzuk; që e ka kokën sa një bozuk; kokëmadh.

kokëbullgár mb. keq. që e ka kokën të madhe e të fortë si të bullgarit; kokëfortë, këmbëngulës: - *Burrë Stojan*, - *ia prisja unë*. - *ti*

kokëbullgar, unë po gllavo arnaut, gjermani po gjerman, ja të shohëm do na shkulin dot nga vendi? (s. andoni, tm).

kokëçomágë mb. keq. që e ka kokën të vogël sa një çomagë.

kokëdamalúg mb. fig. që e ka kokën si damalug; që kërkon të bëhet vetëm e tija.

kokëdúçe mb. keq. që e ka kokën sa të duçes; kokëmadh.

kokëgalínë mb. që e ka kokën sa të galinës; kokëfortë.

kokëgallanoz mb. keq. që e ka kokën sa një gallanoz; kokëmadh; kokëqyp.

kokëgdhë mb. 1. i trashë nga mendja. 2. kokëfortë, që kërkon të bëhet vetëm e tija: *Di që bullgarët janë trima e kokëgdhënj.* (S. Andoni, TM).

kokëgllavínë mb. keq. që e ka kokën sa një gllavinë; kokëmadh.

kokë(h)ínkë mb. keq. që e ka kokën në formën e hinkës; i shëmtuar.

kokëkrasátkë mb. që e ka kokën të vogël.

kokëlajthí mb. që e ka kokën të vogël.

kokëlëmçkë mb. që e ka kokën të vogël: *Tytka e marrazit/ guri i çaparit/ kokëlëmçka.* (Koçillari, TShD).

kokëlëmë mb. që e ka kokën të madhe.

kokëlla(h)útë mb. keq. që e ka kokën sa një llahutë; kokëmadh;

kokëmastrapá mb. keq. që e ka kokën sa një mastrapa.

kokëmollçínë mb. që e ka kokën të vogël e të rrumbullakët; që s'ka tru në kokë.

kokëpáçe mb. me kokë të madhe: *Nofka të tilla si kokëpaçe, për arkitektin e komitetit e për agronomin e farërave, kishin dalë nga goja e saj.* (Th. Naqo, PI).

kokëpjép/ër,-ri m. ai që e ka kokën në formën e pjeprit: kokëpjepri i ardhi rrotull demit trimosh. (th. naqo, m).

kokëpóste mb. keq. që e ka kokën të palarë.

kokëqósh/e, -ja f. njeri që e ka kokën me qoshe: *Kushedi, e hiqni këmbën zvarrë dhe më sjell një nuse edhe ky kokëqoshja.* (T. Laço, M).

kokërrót/ë,-a m. ai që e ka kokën të madhe; kokëtrashë.

kokësallatór,-i mb. që e ka kokën të gjatë e të hollë si sallator; i shëmtuar; kokëkastravec: *Berber kokësallatori lëshoi gërshërët dhe krehrin mbi tavolinë.* ((Th. Naqo, PI).).

kokëshékle mb. keq. i trashë, që s'merr vesh.

kokëshepínë mb. keq. që e ka kokën të gjatë dhe me majë.

kokëshíkëll mb. keq. që e ka kokën të vogël sa një shikëll e të rrumbullaktë.

- kokëtagaxhík** *mb. keq.* e ka kokën sa një targaxhik; kokëmadh.
- kokëvarélë** *mb. keq.* që e ka kokën të madhe sa një varellë; kokëmadh.
- kokëvóckë** *mb.* që e ka kokën të vogël: *Jam i vockë, e nuk di/kokëvockë, mituri!* (K. Zdruli, FDS).
- kokëvóze** *mb. keq.* që e ka kokën të madhe sa një voze; kokëmadh.
- kokëxhërrillë (kokëxhëllírë)** *mb. keq.* që e ka kokën sa një xhërrillë; kokëmadh.
- kokëzhëglínë** *mb. keq.* që e ka kokën sa një zheglinë; kokëmadh.
- kokëzhëng/ë,-a** *m.* njeri i trashë e kokëfortë: *Unë jam krushk në bërzhuk, i kam dhënë vajzën një kokëzhënge nga bërzhuku.* (Th. Naqo, M).
- barkdjégur** *mb.* që nuk ka bërë fëmijë.
- barkfuçi** *mb.* barkmadh.
- barkngjítur** *mb.* i pangrënë, i uritur.
- barkstómnë** *mb.* që e ka barkun të madh; barkmadh.
- barkstúmbë** *mb.* që e ka barkun të madh; barkmadh.
- barkzhurítur** *mb.* që i ka patur fëmijët shumë larg dhe nuk i ka parë kurrë: *Sa t'i ndez një qiri te koka atyre që shkuan barkzhuritur.* (Th. Jorgji, PD).
- turiakshám** *mb.* që rri me fytyrë të vrenjtur, fytyrëngrysur.
- turibýthë** *mb. thjeshtligj.* i shëmtuar në fytyrë: politikanët nuk i njihte me emra, por me nofka si indianët: *Buzëpërveshuri, kokëzbathuri, turibytha, leshpërvjelura.* (H. Lilo, O).
- turikulaçe** *mb.* që e ka fytyrën të madhe e të shëndetshme.
- turilepítke** *mb.* fytyrëhollë.
- turilëmpjété** *mb.* fytyrëhollë.
- turilímë** *mb.* fytyrëhollë.
- turiosháfkë** *mb.* që e ka fytyrën të tharë, të fishkur.
- turimisqín** *mb.* i dobët në fytyrë.
- turimistréc** *mb.* i lig, që sillet keq.
- turimút** *mb. thjeshtligj. shar.* i poshtër.
- turipërvjélë** *ndajf.* duke e shprehur mospëlqimin: *Ato vinin ngadalë, turipërvjelë.* (A. Andoni, G).
- turiplávë** *mb.* që e ka fytyrën të madhe.
- turispanárur** *mb.* që nuk ka tipare të rregullta.
- turishtrémbër** *mb.* që e ka fytyrën të shtrembër.
- turiulluvéqkë** *mb.* fytyrëtharë.
- vetullçapár** *mb. fig.* që i ka vetullat me hark: *-Ç'u vonove nga pazari/ o trim, o vetullçapari.* (K. Zdruli, FDS).

vetullgáze mb. vetullabashkuar, kaleshe, e qeshur, e lumtur: *Syzeza vetullgaze/ dhe të ecurit me naze!* (K. Zdruli, FDS).

vetullgjátë mb. që i ka vetullat të gjata.

vetullgjilpërë mb. që i ka vetullat të holla si gjilpërë, vetullhollë: *Po ay do shkonjë, ty ku do të lerë/ Tynë moj vetullzezë, moj vetullgjilpërë.* (Koçillari, TShd).

vetullmbërthyer mb. që i ka vetullat të rregullta, shumë e bukur: *Mos më ec rrëmbyer/ moj vetullmbërthyer!* (K. Zdruli, FDS).

vetullpijavicë mb. që i ka vetullat të holla, shumë e bukur.

vetullrënë mb. që i ka vetullat të rëna mbi sy, shumë i bukur.

vetullush mb. që ka formën e vetullës: *Ai i dyti rrinte më serbes mbështetur pas pemës dhe pinte duhan vetullush.* (A. Andoni, N).

vetullzëshka mb. që i ka vetullat të zeza: *-O moj Menevishe/ o moj vetullzeshka.* (K. Zdruli, FDS).

Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit ka rëndësi të jmadhe, sepse me regjistrimin e lëndës dialektore pasuron lëndën leksikore, frazeologjike që do të zërë vend në një fjalor “teasarus”.

Ne po japim më poshtë një grup njësisht (kompozita) me ngjyrim të theksuar emocionues, që ndeshen në ligjërimin e thjeshtë dhe në formatin e një fjalore të tillë do të jenë pjesë e tij:

bythëdërmón mb. keq. që kërkon të hajë shumë a të marrë më shumë për vete; bythëmádh.

bythëkróm/ë,-a f. xinxife; trëndafil i egër.

bythëlëvizur mb. që nuk rri në një vend.

bythëmádh mb. keq. që ha shumë.

bythëmút mb. thjeshtligj. i papastër, i ndotur.

bythëpalárë mb. thjeshtligj. i papastër, i ndotur.

bythëpambúk mb. keq. përtac, që bën vetëm punë të lehta.

bythëpëdrédhur mb. dredharak, që nuk e mban fjalën.

bythëpollonícë mb. keq. që e ka bythën të madhe.

bythështrémber mb. i shëmtuar në trup.

bythëtrashë mb. bythëmádh.

bythëthárë mb. keq. i dobët në trup.

bythëvérdhë mb. i dobët: - *Cilët janë bythëverdhë?* –pyeti Magelani. -*Të përkëdhelurit, Magelan. Ata që nuk i ka zënë as era, as shiu, por që kanë punuar nëpër zyra.* (Th. Naqo, PI).

19.2. Njësi frazeologjike që pasurojnë leksikun normativ

Përmes Fjalorit leksiko-frazeologjike të Devollit bëhet pasurimi i fondit leksikor kombëtar të botuar dhe me dhjetëra e dhjetëra **njësi**

frazeologjike. Nuk po sjellim për ilustrim njësi që kanë ngarkesë të theksuar emocionuese (si te njësitë me *bythë*, *bark* etj.), ku njësitë janë në shumicën dërmuese të papasqyruara në fjalorët në qarkullim, por njësi që janë shumë më asnjëse dhe nuk ndeshen vetëm në thjeshtligjërime. Konkretisht, vetëm te grupi me njësi frazeologjike të motivuara me fjalën sy gjejmë 26 njësi që nuk janë të pasqyruara në botimet e deritanishme leksikografike e frazeografike të shqipes (njësitë që janë me shkronja të pjerrëta dhe me shkronja të mëshuara). Kjo nuk është pasuri e paktë, përkundrazi.

sý,-ri m. ❖ *na e bëri syrin bakër* dikush-ka kohë që s'e kemi parë, na ka marrë malli shumë. ❖ *i bëjnë sytë çift a tek* dikujt-keq. është çakërr; sheh vëngër. ❖ *s'ia bën syri tërt* dikujt-nuk ka frikë. ❖ *ma bëtë syrin xham* - më nderuat, më zbardhët faqen. ❖ *i janë bërë (i dolën) sytë pufka* dikujt-i kanë kërcyer sytë nga lodhja a pagjumësia. ❖ *më bënë (më lëshuan) sytë xixa-e* pësova keq nga goditja e dikujt a diçkaje. ❖ *syri jot dë bythë të qenit, bytha jote majë hostenit* - thjeshtligj. ❖ *çaploi sytë* dikush-u çudit pa masë. ❖ *sa t'i dalin sytë*-sa të lodhet shumë, sa të mos ketë më fuqi. ❖ *të dalçin sytë!*-mallk. ❖ *i ka dalë syri jashtë* dikujt-i është rritur mendja, s'flet dot me të. ❖ *iu err syri* dikujt-e humbi gjykimin, bën veprime të pamenduara. ❖ *m'u errën (m'u veshën) sytë-e* humba shikimin, nuk shikoj mirë. ❖ *të ha me sy* dikush-të ka inat, të shikon vëngër. ❖ *s'ma ha syri* diçka-nuk jam i zoti ta bëj një punë; e kam të vështirë. ❖ *ta hëngsha syrin*-thuhet kur lakmohet një vajzë e bukur. ❖ *t'ia hash sytë dikujt* - t'i kërkosh diçka me shumë zor; t'ia huash. ❖ *nuk më hyn në sy* diçka-nuk më pëlqen nga pamja; s'ma mbush syrin. ❖ *i hynë sytë dë trut* dikujt-është dobësuar shumë. ❖ *iku nga sytë këmbët*-u largua me të shpejtë nga frika. ❖ *mua më iku syri, do të qaj kropallat* - përdoret kur dikush humb diçka me shumë vlerë në krahasim me diçka tjetër. ❖ *e ka syrin katriq dikush*- sheh mirë e larg. ❖ *ku i ke sytë?*-ki kujdes! ❖ *më ka syri turp*-jam njeri me sedër. ❖ *e ka syrin të ngopur* dikush-është rritur me të mirave, nuk shikon gjënë e tjetrit. ❖ *e ka syrin filxhan* dikush-nuk i flihet. ❖ *ka sy edhe prapa kokës* dikush-nuk i shpëton asgjë, është shumë i vëmendshëm. ❖ *s'ka sy për qabe* dikush-nuk është i zoti për atë punë. ❖ *kullot sytë*-kaloi kohën. ❖ *s'na la sy e faqe* dikush - na turpëroi, na nxu faqen. ❖ *i lëshuan sytë miza-i* dhembti shumë. ❖ *më mbetën sytë* diku a te diçka-u habita. ❖ *më mbiu dë syt* dikush-keq. më mërziti nga që e shoh gjithnjë. ❖ *ta mbyll synë* dikush a diçka-të turpëron. ❖ *ta merr pe syrit*-i kupton të gjitha pa ia thënë; është shumë i zgjuar. ❖ *s'i ndajnë sytë (mirë) dikujt*-nuk shikon mirë. ❖ *i ndriti sytë si maçoku dë pastërmat* dikush-

keq, është ziliqar. ❖ **sa për të ngopur syrin-** ka vetëm bukurinë dhe asgjë tjetër. ❖ **është për t'i nxjerrë (për t'i qitur) sytë** dikush-1. është shumë i shkathët, nuk ia hedh dot. 2. është shumë i lig. ❖ **ta nxjerr pe syrit diçka / dikush**-është shumë këmbëngulës. ❖ **i perëndoi sytë** dikush-është shumë keq, është gati në të vdekur. ❖ **e prishi syrin** dikush-është gati për sherr. ❖ **i qanin sytë si llozenkë dikujt**-qante me të madhe. ❖ **syri i lig pëlçet kalin (gurin)-fj.** u. sipas besimit, nga syri i keq sëmuresh. ❖ **na piu sytë dikush**-nuk na ndahet, nuk këmbëjmë dot një fjalë me njëri-tjetrin. ❖ **s'i kanë plasur sytë (pa plasur sytë)** dikujt-sapo e kanë varrosur. ❖ **qita sytë-1.** qepa për një kohë të gjatë. 2. lexova shumë, m'u lodhën sytë. ❖ **ia rrahin synë dikujt**-ia kujtojnë vazhdimisht një gjë. ❖ **i rrodhën sytë**-u plak, nuk sheh mirë. ❖ **s'shikohet dë sytë dikush**-është shumë e bukur. ❖ **ç'i sheh syri ia bën dora**-është njeri i zoti, i vjen ndoresh për çdo gjë. ❖ **i pa syri ibret dikujt**-u tremb shumë, u tmerrua. ❖ **mos të pafsha sytë!**-mallk. nuk dua të të shoh më. ❖ **i pa syri synë dikujt**-vuajti shumë. ❖ **nuk pa dy sy njeriu dikush**-është njeri i padalë, e ka kaluar gjithë jetën brenda katër mureve nga hallet që ka pasur. ❖ **shih me sy e plas me zemër**-thuhet për dikë që e dëshiron, por nuk e ke. ❖ **ia vuri syrin diellit**-nuk ka asnjë punë. ❖ **sa për t'i zënë sytë**-duke bërë diçka për ta mashtruar. ❖ **i ka zënë syri bakër dikujt**-i hahet shumë një gjë. ❖ **i kanë zënë sytë pezhishka dikujt**-nuk e kupton rrezikun, të keqen. ❖ **i zë sytë dikujt**-e gënjej, e mashtroj, ia hedh dikujt. ❖ **i kanë zënë sytë cipë dikujt**-nuk di se ç'bën, punon kuturu, s'ka turp.

20. Vend për përmirësime (disa propozime e vërejtje)

Fjalori, në një ribotim të ardhshëm, mendojmë se kërkon një shikim redaktues e korrektues.

20.1. Emrat e përveçëm të njerëzve, emërvendet, si dhe emrat e banorëve sipas fshatit, qytetit, krahinës etj. mund të mos jepeshin si zëra të mëvetësishëm leksikografikë, por si pjesë tematike e veçantë e Fjalorit (pra fjalori veç pjesës zemër që formohet nga pasuria leksiko-frazeologjike, të kishte dhe pjesë të tjera). Këtu lehtësisht mund të përfshiheshin dhe emërtimet dygjymtyrëshe të kësaj semantike (të cilat jepen brenda një zëri leksikografik që shënon përkatësinë funksionale të emërtimeve të tilla (arë, grykë, çezmë, përrua etj.)

20.2. Fjalët e eptueshme në Fjalor mund (duhet) të jepeshin me elementet kryesore të eptimit (treguesit gramatikorë të shumësit tek emrat, e kryera e thjeshtë dhe pjesorja e foljeve etj.). Kjo është e domosdoshme për një fjalor dialektor, sepse pasuria leksikore dialektore është një nga burimet kryesore të pasurimit të leksikut normativ. Dhe kjo kërkon dhe

saktësinë e paradigmës së plotë eptimore të njësisë që është pjesë e këtij procesi pasurues.

20.3. Në mikrostrukturën e një zëri leksikografik, ku ka njësi frazeologjike dhe emërvende, njësitë frazeologjike duhet të të paravendosen ndaj këtyre të fundit, sepse toponomastika është më larg strukturës kuptimore të një njësie të dhënë sesa njësia frazeologjike.

20.4. Ka njësi që si fjalë titull kanë dalë me një element të paradigmës së eptimit, kur fjalori kërkon trajtën përfaqësuese të tyre. Fjala vjen folja *vete* nuk është dhënë në mënyrën dëftore, në kohën e tashme, në numri njëjës, në vetën e parë, por është dhënë me formën e së kryerës së thjeshtë, veta e tretë: **vâte fol.** 1. shkoi: *Zu e na bluan mulliri/ me tri pika ujë viri/ të nëntën na e bloi/ të dhjetën na e shteroi/ vate plaka e lëshoi.* (Koçillari, TShd). 2. vajti, mbaroi, nuk do të jetë më: *-Po na iku, ore djema, vate Devolli i tërë, në hell do t'i shkojë fëmijët ky xhelati i Kullës.* (S. Andoni, MSh). 3. pj. për pak: *E mundëm e vate.* (D. Agolli, NjK).

20.5. Në ndonjë fjalë shumëkuptimëshe, organizimi i strukturës kuptimore mund të bëhet sipas vlerës shënuese e dendurisë së përdorimeve të kuptimeve. Kështu, te folja *kalit*, kuptimi i parë duhet të ishte i treti dhe i treti duhet të ishte i pari.

kalít fol. 1. bëj me daltë gurin e mullirit për të bluar më mirë: *- Po ti, moj zonja Gjenë, e paske bereqetin shumë të mbushur! Po do na zërë egjra, moj, do na marrësh fëmijët më qafë, moj! Unë sapo kalita gurët, moj...* (S. Andoni, P). 2. rrah, godas kosën me çekiç kur është trashur tehu. 3. i hedh ujë hekurit të nxehtë për ta bërë çelik.

20.6. Rrallëherë, në sintagmatikën e fjalës ndeshesh me ndonjë gabim, që më shumë është pakujdesi, sesa pasaktësi shkencore. Kështu te kuptimi i parë i foljes *ronit* është dhënë shembulli me mbiemër prejpjesor (së ronitur), kur kërkohej ilustrim me folje. **ronít fol.** 1. shkërmoq, thërrmoj, shkoq (misrin etj.): *Larguam krevatet nga pikat që pikonin prej suvasë së ronitur të tavanit dhe hapëm stimën për ngrohje.* (H. Lilo, KMK). 2. derdh, nxjerr lotë: *Qaj me lot e ronit lot/ moj nuse, lule/ për kë të vjen keq më fort? / - Për baban' që s'e le dot/ andaj qaj e ronit lot!* (K. Zdruli, FDS); *- Ç'ka imzot që ronit lot?/ - Ce i ra mëhyri dë pust* (H. Koçillari, TShd).

Po kështu në rastin në vijim ndajfolja është shpjeguar me sinonimi mbiemërore: **dhallëngjyer ndajf.** i varfër, i këputur. ❖ *doli dhallëngjyer* dikush-punoi shumë e fitoi pak.

20.7. Ndonjë shpjegim kërkon saktësi më të madhe dhe qartësi kuptimore. Fjala vjen emri *perçinë* shënon një send, një lloj kopse

metalike, kurse shpjegimi është dhënë si emërtim procesi: **perçin/ë,-a m.** të shtypurit e majës a të thumbit për të puthitur dy pjesë metalike: *Qaforja ishte mbërthyer paq me perçina nga kovaçi i fshatit.* (H. Lilo, KMK).

20.8. Tek-tuk në vepër duhej treguar më shumë kujdes për ndonjë korrektim të saktë gjuhësor, si në rastin e mëposhtëm ku përshtatja e mbiemrave me gjymtyrën drejtuese (tufë) është e gabuar (kuptimi 1): **ergjelë,-ja f.** 1. tufë kuajsh a pelash i lirë, i palidhur, i lëshuar: *Rrebeshi takoi mbi qytet si një ergjele e trembur kuajsh, duke derdhur me duf zemërimin e zhegut të gjatë të verës.* (T. Laço, TSh). 2. *ndajf.* lëshuar, pa pengesë: *Një tufë rrezesh si ergjele, argaliset një çast me perdet e rënda të dhomës, pastaj vërshon brenda.* (T. Laço, TZ).

20.9. Ndonjëherë kemi kompozita me gjymtyrë fjalë me përcaktim rasor, të cilat mendoj se nuk janë ngjizur ende si një fjalë, por shfaqen me strukturë të hapur dygjymtyrëshe. Konkretisht njësia *bukësheqeri*, është dhënë si emër femëror (f.), por nuk del si e tillë, edhe pse në mendësinë e folësit lidhet me emrin e gjinisë femërore *bukë*. Kjo tregon se struktura e saj është e hapur. Ilustrojmë nga *Fjalori*: **bukësheqéri f.** ëmbëlsirë tradicionale e fshatrave të Devollit, që bëhet me vezë të rrahura, miell dhe shurup sheqeri: *Sihariq se t'erdh jot ëmë/ buksheqeri sa një lëmë/ sipr' e posht' të djegur/ brenda qull papjekur!* (K. Zdruli, FDS).

20.10. Gjithashtu, ka struktura kuptimore që duhet të ndahen ose të saktësohen. Te kompozita *vetullgaze* janë dhënë si shpjegim katër sinonime, por dy sinonimet e para nuk lidhen semantikisht me dy të dytat (mund të jesh *vetallabashkuar* apo *kaleshe* dhe mund të mos jesh i gëzuar apo i lumtur). **vetullgáze mb.** *vetullabashkuar, kaleshe, e qeshur, e lumtur: Syzeza vetullgaze/ dhe të ecurit me naze!* (K. Zdruli, FDS).

Për të çuar më tej arsyetimin po sjellim nga *Fjalori* njësitë *kalesh* në kuptimin e dytë dhe *kaleshe*: **kalésh,-i m.** 1. dash me shumë lesh, leshtor: *Ç'më kërkuan nga dy deshë/ Unë u thashë i zini vetë/ Ç'ma zunë kaleshnë e shkretë/ Për kaleshnë vritem vetë.* (Koçillari, TShD). 2. *fig.* djalë me flokë e vetulla të errëta dhe fytyrëbardhoshe; syzi, vetullzi: *Hapu moj bunacë, bëju vetëtimë/ kur të vjen kaleshi, më s'ta gjen shtëpinë.* (K. Zdruli, FDS). **kalésh/e,-ja f.** vajzë me flokë e vetulla të errëta dhe fytyrëbardhoshe; syzezë, vetullzezë.

Pavarësisht këtyre vërejtjeve për disa mangësi anësore dhe, që siç shihen, janë lehtësisht të korigjueshme e të mënjanueshme, mendoj se *Fjalori* është jo vetëm një regjistruer i një pasurie të shumëllojshme të lëndës gjuhësore (e sidomos asaj leksikore e frazeologjike), por është një burim i vlerësuar dhe me rëndësi të madhe për punën e ardhshme

afatshkurtër e afatmesme për të marrë lëndë gjatë punës për hartimin e fjalorëve të rinj kombëtarë, qoftë normativë, qoftë dhe për fjalorin thesaurus të gjuhës shqipe. Gj. Shkurtaaj shkruan: “Shpreh bindjen time se vepra *“Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit”* i prof. dr. Ali Jasharit meriton të jetë libër pune në tryezën e çdo studiuesi të gjuhës shqipe, një libër i dobishëm edhe për shkrimtarët e poetët që dëshirojnë ta “ngjyejnë” penën në leksikun e frazeologjinë e pasur dhe aq të thekur të Devollit, duke gjetur aty, pa dyshim, prurje të bukura e të vlefshme për individualizimin dhe tipizimin e personazheve letrarë, po edhe mirëfilli për të shtuar fjalë të bukura e krijime origjinale me mjetet e shqipes, që vijnë si prirje aq të shumta e të bukura në këtë libër.”⁸

Dhe duke e mbyllur këtë vështrim të përgjithshëm për këtë vepër, përsëri po i referohem akademikut Gjovalin Shkurtaaj, i cili shprehet se “Për vlerat dhe prurjet e freskëta, sidomos për pasurinë e madhe të fjalëve dhe frazeologjizmave të Devollit, vepra *“Fjalori leksiko - frazeologjik i Devollit”* plotëson një njohje të gjerë e të munguar të pasurisë leksikore e frazeologjike të njërës prej krahinave më tipike të Shqipërisë së Jugut. Ai radhitet, pa dyshim, krahas fjalorëve më të mirë të shqipes së sotme dhe të fjalorëve krahinorë, duke u bërë një dëshmi e shkruar e fjalës që gjallon në gjuhën e folur, sepse, kur fjala e gjallë zë vend në një fjalor, është e sigurt që nuk ka për t’u harruar sa të jetë vetë populli që e flet atë.”⁹

⁸ Gj. Shkurtaaj, *po aty*, f. 11.

⁹ Gj. Shkurtaaj, *po aty*, f. 11.